



Zyra për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut

ISH-REPUBLIKA JUGOSLLAVE E MAQEDONISË

ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PARLAMENTARE
11 dhjetor 2016

Misioni i OSBE/ODIHR për Vëzhgimin e Zgjedhjeve
Raporti përfundimtar



Varshavë
28 shkurt 2017

PËRMBAJTJA

I.	PËRMBLEDHJE	1
II.	HYRJE DHE FALËNDERIME	3
III.	SFONDI DHE KONTEKSTI POLITIK	4
IV.	SISTEMI ZGJEDHOR	4
V.	KORNIZA LIGJORE	5
VI.	ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE	6
VII.	REGJISTRIMI I VOTUESVE	9
VIII.	REGJISTRIMI I KANDIDATËVE	12
IX.	FUSHATA	13
X.	FINANCIMI I FUSHATËS	15
XI.	MEDIAT	16
	A. KLIMA MEDIATIKE	16
	B. KORNIZA LIGJORE PËR MEDIAT	16
	C. REZULTATET E MONITORIMIT TË MEDIAVE.....	18
XII.	VËZHGUESIT VENDORË DHE NDËRKOMBËTARË	19
XIII.	ANKESAT DHE APELIMET	20
XIV.	PJESËMARRJA E PAKICAVE KOMBËTARE	21
XV.	VOTIMI I PARAKOHSHËM DHE DITA E ZGJEDHJEVE	22
	A. VOTIMI I PARAKOHSHËM DHE ME POSTË	22
	B. VOTIMI	23
	C. NUMËRIMI I VOTAVE DHE NXJERRJA E REZULTATEVE.....	23
	D. SHPALLJA E REZULTATEVE PARAPRAKE.....	24
XVI.	ZHVILLIMET PAS DITËS SË ZGJEDHJEVE DHE ANKESAT	24
	A. ANKESAT NË KSHZ PAS DITËS SË ZGJEDHJEVE	24
	B. APELIMET NË GJYKATËN ADMINISTRATIVE.....	25
	C. RIVOTIMI DHE REZULTATET PËRFUNDIMTARE.....	26
XVII.	REKOMANDIME	26
	A. REKOMANDIME PRIORITARE	26
	B. REKOMANDIME TJERA	27
	ANEKS I: ANEKS 1: REZULTATET PËRFUNDIMTARE	30
	ANEKS II: LISTA E VËZHGUESVE NË MISIONIN VËZHGUES NDËRKOMBËTAR TË ZGJEDHJEVE	31
	RRETH OSBE/ODIHR	39

ISH-REPUBLIKA JUGOSLLAVE E MAQEDONISË
ZGJEDHJET E PARAKOHSHME PARLAMENTARE
11 dhjetor 2016

Raporti Përfundimtar i Misionit të OSBE/ODIHR për Vëzhgimin e Zgjedhjeve¹

I. PËRMBLEDHJE

Në përgjigje të ftesës zyrtare, Zyra për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut e OSBE-së (OSBE/ODIHR) ngriti një Mision për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MVZ) për të vëzhguar zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 11 dhjetorit. Misioni vlerësoi përputhshmërinë e procesit zgjedhor me angazhimet e OSBE-së, me detyrimet dhe standardet tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike, si dhe me legjislacionin vendas. Ditën e zgjedhjeve, MVZ-ja e OSBE/ODIHR u shoqërua nga delegacionet e Asamblesë Parlamentare të OSBE-së (AP OSBE), Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (PACE) dhe të Parlamentit Evropian (PE) për të formuar Misionin Ndërkombëtar për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MNVZ).

Deklarata e Gjetjeve dhe Përfundimeve Paraprake e nxjerrë nga MNVZ-ja në 12 dhjetor arriti në përfundimin se “zgjedhjet e parakohshme parlamentare ishin një hap i rëndësishëm për zgjidhjen e krizës së thellë politike dyvjeçare. Forcat kryesore politike ranë dakord për një varg ndryshimesh ligjore dhe institucionale për të siguruar kushte të drejta dhe të barabarta për mbajtjen e këtyre zgjedhjeve. Çështje të rëndësishme, siç janë regjistrimi i votuesve dhe mediat, akoma ngelin të trajtohen në një mënyrë të qëndrueshme. Fushata ishte konkurruese por u mbajt në një atmosferë të karakterizuar me mosbesim të publikut ndaj institucioneve dhe establishmentit politik, si dhe pretendime për kërcënime ndaj votuesve. Administrata zgjedhore u mundua mjaft me përgatitjet e zgjedhjeve dhe shkeli një numër të afateve, mirëpo dita e zgjedhjeve përgjithësisht ishte mirë e administruar dhe kaloi pa incidente të mëdha”.

Korniza ligjore përgjithësisht është e favorshme për mbajtje të zgjedhjeve demokratike. Si rezultat i Marrëveshjes së Përzihos ku u përcaktuan masa për zgjidhjen e krizës politike, përmirësimet e rëndësishme të legjislacionit zgjedhor në vitin 2015 pozitivisht trajtuan shumicën e rekomandimeve të mëparshme të OSBE/ODIHR dhe Komisionit të Venecias të Këshillit Evropian. Amendamentet plotësues në vitin 2016 vendosën mekanizma të përkohshëm për mbikëqyrje ndërpartiake të aspekteve kryesore të procesit zgjedhor dhe ndryshimet në sistemin zgjedhor jashtë vendit. Megjithatë, disa rekomandime ngelin të pa trajtuara dhe dispozita të caktuara janë të dykuptimshme ose bien ndesh me ligje tjera. Po ashtu, edhe pse procesi zgjedhor gëzoi mbështetjen e katër partive më të mëdha politike, ndryshimet ligjore u aprovuan me ngut nga parlamenti dhe pa konsultime kuptimplotë me bartësit relevant të zgjedhjeve, që është në kundërshtim me angazhimet e OSBE-së.

Përgatitjet e zgjedhjeve nga Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve (KSHZ) u vështirësuan nga organizimi joefikas i brendshëm, nga vendimmarrja e politizuar dhe afatet e shkurtuara ligjore. Edhe pse përgatitjet përfunduan deri në ditën e zgjedhjeve, KSHZ-ja shkeli disa afate kohore dhe nuk qartësoi disa procedura. Puna e KSHZ-së nuk ishte gjithmonë transparente sepse shpeshherë mbajti seanca të mbyllura dhe jo gjithmonë publikoi vendimet. Komisionet në nivel më të ulët përgjithësisht punuan në mënyrë profesionale, megjithëse disa prej tyre kishin mungesë të hapësirës, financimit në kohë, resurseve dhe mjeteve adekuate. Kriteret për përfaqësim të balancuar etnik dhe gjinor në komisionet zgjedhore u respektua në masë të gjerë. Dy nga nëntë anëtarët e KSHZ-së janë gra.

¹ Versioni në gjuhën angleze i këtij raporti është dokumenti i vetëm zyrtar. Përkthimet jozyrtare në gjuhën maqedonase dhe shqipe janë gjithashtu në dispozicion.

Me qëllim të adresimit të mosbesimit të vjetër në saktësinë e listave të votuesve, KSHZ-së iu dha për detyrë të rishikojë regjistrin e votuesve me kontrolle të kryqëzuar të disa bazave të të dhënave dhe me kryerje të kontrolleve në terren. Procesi i rishikimit i vëzhguar nga katër partitë më të mëdha politike rezultoi me një numër të limituar të fshirjeve. Përderisa procesi në njëfarë mënyre përmirësoi saktësinë e listës së votuesve, ai në mënyrë efektive privoi një numër të qytetarëve nga mundësia për të votuar, në kundërshtim me standardet ndërkombëtare dhe praktikës së mirë. Për më tepër, marrëveshja politike për rishikimin e regjistrit të votuesve dhe për masat e mëtutjeshme ishin të zbatueshme vetëm për këto zgjedhje, duke lënë të pa trajtuara disa mangësi ligjore dhe strukturore mbi mirëmbajtjen e regjistrit të votuesve.

KSHZ-ja regjistroi gjashtë parti politike dhe pesë koalicione gjatë një procesi përgjithësisht përfshirës. Partitë dhe koalicionet që kryesisht përfaqësuan komunitetin etnik shqiptar garuan në mënyrë të pavarur, ndërsa partitë dhe kandidatët që përfaqësuan komunitetet etnike më të vogla u bashkuan me koalicionet e udhëhequra nga partitë që përfaqësuan komunitetet më të mëdha. Procesi i regjistrimit të kandidatëve ishte përgjithësisht përfshirës por u ndikua negativisht nga mungesa e qartësisë ligjore në disa aspekte të procesit të propozimit dhe regjistrimit, përfshirë edhe verifikimin e nënshkrimit dhe ridorëzimit të dokumenteve për regjistrim, si dhe mënyrën e verifikimit të dokumentacionit nga ana e KSHZ-së.

Në pajtim me kuotën e rritur për pjesëmarrje të grave, 41 për qind të kandidatëve ishin gra. KSHZ-ja regjistroi tre lista të kandidatëve që nuk përmbushnin kriterin gjinor. U zgjodhën tridhjetë e tetë gra (31.6 për qind), katër më pak se në parlamentin e mëparshëm. Gratë nuk ishin mjaft të përfaqësuara në fushatë, si pjesëmarrëse dhe si folëse në tubime.

Partitë politike në përgjithësi kishin mundësinë të bëjnë fushatë lirshëm, dhe liritë themelore për bashkim, tubim dhe shprehje u respektuan. Porositë kryesore u përqendruan në ekonomi, migrimin e rinisë dhe krijimin e vendeve të punës. Përderisa shumica e garuesve zhvilluan fushatë pozitive, u vërejt edhe retorikë nxitëse dhe negative. Pretendimet për frikësim të votuesve, përdorim force, trysni ndaj punonjësve publik, blerje votash, dhe keqpërdorim të resurseve administrative vazhduan gjatë tërë fushatës. MVZ-ja e OSBE/ODIHR verifikoi mbi dhjetë nga këto pretendime. Veprimet e tilla ngritën shqetësime për mundësinë e votuesve për të hedhur votën e tyre pa frikë nga ndëshkimi, siç kërkohet me paragrafin 7.7 të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së i vitit 1990.

Rregulloret për financim të fushatës janë gjithëpërfshirëse dhe obligojnë raportim të shpeshtë nga ana e garuesve. Megjithatë, transparenca dhe llogaridhënia ishin zvogëluar për shkak të kushtit për sigurim të provave dokumentuese për kontributet dhe harxhimet. Siç njoftuan garuesit, nuk janë marrë masa kundër tejkalimit të shpenzimeve për fushatë.

Temat lidhur me marrëdhëniet ndëretnike u paraqitën dukshëm në fushatë, përfshi edhe raportet institucionale mes komuniteteve etnike shqiptare dhe maqedonase, dhe përdorimin zyrtar të gjuhëve. Gara ishte veçanërisht konkurruese tek komuniteti etnik shqiptar, me forcat e reja të formuara politike që sfidonin pozitën dominuese të partive më të vjetra. Lidhja Social Demokrate e Maqedonisë në mënyrë aktive kërkoi votat nga komuniteti etnik shqiptar përfshirë edhe vendosjen në listë të kandidatëve etnik shqiptarë. Mediat të cilët raportonin për kandidatët Romë shpesh përdornin stereotipa.

Ndryshime të rëndësishëm të Kodit Zgjedhor të vitit 2015 trajtuan një numër të shqetësimeve në media, mirëpo reformat e rëndësishme në media, të parapara me Marrëveshjen e Përzhinës, nuk u materializuan. Monitorimi i medias nga ana e MVZ-së të OSBE/ODIHR tregon se garuesit zgjedhorë kishin qasje tek mediumet për të bërë fushatë, përfshirë edhe emetimin falas të transmetuesve publik. Kanalet televizive publike në përgjithësi iu bindën rregullores për mbulimin e garuesve gjatë fushatës. Televizionet private Sitel, Kanal 5 dhe Alfa nuk siguruan mbulim të balancuar dhe të paanshëm në

lajmet e tyre, duke u përqendruar në mesazhet e fushatës të koalicionit qeverisës. Informacione të pasigurt që vinin nga interneti prezantoheshin kohë pas kohe si lajme politike. Alsat-M, Telma dhe 24 Vesti në edicionet e tyre të lajmeve në përgjithësi ofruan mbulim të shumëllojshëm dhe shpesh kritik për garuesit dhe aktorët politik.

Pavarësisht përmirësimeve të bëra në ligj dhe miratimit të rregullores së KSHZ-së për ankesat dhe apelimet, zbatimi i procedurave për zgjidhjen e kontesteve zgjedhore nuk mundësoi plotësisht kompensim efektiv juridik, siç parashikohet në angazhimet e OSBE-së dhe standardet e Këshillit të Evropës. Shumica e ankesave të parashtruara në administratën zgjedhore dhe në gjykatë u refuzuan në bazë procedurale ose të juridiksionit. Gjykata Administrative mbajti seancat dëgjimore me dyer të mbyllura. Një numër i bashkëbiseduesve të MVZ-së të OSBE/ODIHR ngritën shqetësimet e tyre lidhur me pavarësinë e gjyqësorit.

Dita e zgjedhjeve vijoi në mënyrë paqësore dhe pa incidente të mëdha, dhe votuesit morën pjesë në numër të madh. Procesi i votimit përgjithësisht u vlerësua pozitivisht nga vëzhguesit, megjithëse u vërejtën disa parregullsi procedurale, veçanërisht gjatë numërimit dhe nxjerrjes së rezultateve. Vëzhguesit vërejtën një numër të personave të cilëve nuk iu lejua të votojnë pasi që ishin fshirë nga Lista e votuesve gjatë rishikimit të fundit të regjistrit të votuesve. Procesi zgjedhor fitoi në transparencë me praninë aktive të një numri të madh të vëzhguesve civilë dhe partiak. Konkretisht, KSHZ-ja publikoi në faqe të internetit rezultatet paraprake nga vendvotimet gjatë terë natës ndërsa rezultatet paraprake në nivel shtetëror i publikoi me vonesë.

Periodha post-zgjedhore u shënuar me atmosferë të tensionuar dhe me retorikë të ashpër, kryesisht nga partia në pushtet, udhëheqësit e të cilës akuzuan KSHZ-në dhe një numër të përfaqësuesve rezident të komunitetit diplomatik për ndërhyrje zgjedhore. Si rezultat i një ankese të një partie opozitare u organizua rivotim në një vendvotim, i cili nuk ndryshoi rezultatin zgjedhor.

II. HYRJE DHE FALËNDERIME

Në përgjigje të ftesës zyrtare, Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE/ODIHR) ngriti Misionin për Vëzhgim të Zgjedhjeve (MVZ) me datë 3 nëntor për të vëzhguar zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 11 dhjetorit. MVZ-ja e kryesuar nga Tana de Zulueta, përfshinte një ekip ekspertësh 16 anëtarësh të vendosur në Shkup dhe një ekip me 20 vëzhgues afatgjatë (VAGJ) të pozicionuar në mbarë vendin në 9 nëntor. MVZ-ja e OSBE/ODIHR qëndroi në vend deri më datë 23 dhjetor për të përcjellë zhvillimet pas ditës së zgjedhjeve.

MVZ-ja e OSBE/ODIHR vlerësoi përputhshmërinë e procesit zgjedhor me angazhimet e OSBE-së dhe standardet dhe detyrimet tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike, si dhe me legjislacionin vendas. Ky raport përfundimtar pason Deklaratën e Gjetjeve dhe Përfundimeve Paraprake të nxjerrë gjatë konferencës për shtyp në Shkup në 12 dhjetor dhe që është në dispozicion në faqen e internetit të OSBE/ODIHR.²

MVZ-ja e OSBE/ODIHR falënderon autoritetet për ftesën për të vëzhguar zgjedhjet, gjithashtu Komisionin Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ), Ministrinë e Punëve të Jashtme përfshirë edhe misionin e përhershëm të kësaj ministrie në Vjenë, si dhe autoritetet tjera shtetërore e lokale për mbështetjen dhe bashkëpunimin e tyre. MVZ-ja gjithashtu dëshiron të shprehë falënderimet e saj partive politike, organizatave të shoqërisë civile dhe përfaqësuesve të mediave për bashkëpunimin e tyre, si dhe Misionit të OSBE-së në Shkup, përfaqësive diplomatike të shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së dhe organizatave ndërkombëtare të akredituara në vend, për bashkëpunimin dhe ndihmën e tyre.

² Shih të gjitha [raportet paraprake të OSBE/ODIHR](#) për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë.

III. SFONDI DHE KONTEKSTI POLITIK

Zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 11 dhjetorit janë konsideruar në përgjithësi si një test vendimtar për funksionimin e institucioneve demokratike, që vijnë pas krizës së thellë politike dyvjeçare.³ Këto janë zgjedhjet e katërta të parakohshme parlamentare të njëpasnjëshme që nga viti 2008. Zgjedhjet e mëparshme u mbajtën në vitin 2014 dhe ato rezultuan në një qeveri të formuar nga Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Demokratike për Unitet Kombëtar Maqedonas (VMRO-DPMNE) me 61 mandate, dhe Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI) me 19 mandate. Opozita përfshinte Lidhjen Social Demokrate të Maqedonisë (LSDM) me 34 mandate dhe Partinë Demokratike Shqiptare (PDSH) me 7 mandate. Rilindja Demokratike Kombëtare (RDK) dhe Opsioni Qytetar për Maqedoninë kishin nga një mandat.

Partia kryesore opozitare bojkotoi parlamentin me pretendime se zgjedhjet në vitin 2014 ishin të manipuluar. Kriza u thellua në shkurt të vitit 2015 kur regjistrimet e paligjshme të përgjimeve inkriminuese me të cilët pretendohet implikimi i zyrtarëve qeveritarë dhe publik në korrupsion, manipulime zgjedhore dhe keqpërdorim të detyrës, çuan në protesta të gjera. Më 15 korrik, si pjesë e Marrëveshjes së Përzghinos të ndërmjetësuar nga ndërkombëtarët, u shpallën zgjedhjet e parakohshme parlamentare për 24 prill 2016, si dhe u themelua Zyra e Prokurorisë Speciale për hetimin e pretendimeve të dala nga përgjimet.⁴

Zgjedhjet u shtynë për në 5 qershor 2016 me arsyetimin se kushtet kryesore nuk ishin të plotësuar, siç ishte pastrimi i Listës së votuesve, reformat në media, dhe masat mbrojtëse për ndarjen e shtetit nga aktivitetet partiake, dhe në 7 prill u bë shpërbërja e parlamentit. Klima politike u përkeqësua pas 12 prillit kur Presidenti Gjorge Ivanov shpalli falje të përgjithshme për të gjithë personat e akuzuar, ndër hetime ose të dyshuar për përfshirje në skandalin e përgjimeve. Falja nxiti protesta dhe kundër-protesta. Protestuesit, ndër ombrellën *Protestiram*, kërkuan dorëheqjen e Presidentit dhe anulimin e zgjedhjeve. Opozita bojkotoi zgjedhjet dhe, nga katër nënshkruesit e Marrëveshjes së Përzghinos, vetëm VMRO-DPMNE dorëzoi listën e kandidatëve. Në 25 maj Gjykata Kushtetuese shpalli shpërbërjen e parlamentit si antikushtetuese dhe zgjedhjet e 5 qershorit u anuluan.⁵

Në 20 korrik, katër partitë kryesore politike, me ndërmjetësimin e BE-së dhe Shteteve të Bashkuara, firmosën marrëveshje të re e cila parasheh mbajtjen e zgjedhjeve deri në fund të vitit.⁶ Në 17 tetor parlamenti u shpërbë dhe zgjedhjet u shpallën për 11 dhjetor.

IV. SISTEMI ZGJEDHOR

Me mandat katërvjeçar zgjidhen prej 120 deri 123 anëtarë të parlamentit (deputetë) sipas sistemit proporcional me lista të mbyllura. Nga njëzet deputetë zgjidhen në secilën prej gjashtë njësive zgjedhore të vendit. Si rezultat i ndryshimeve të bëra në Kodin Zgjedhor në vitin 2015 deri në tre deputetë plotësues zgjidhen në një njësi zgjedhore jashtë shtetit. Numri i deputetëve të fituar në njësinë zgjedhore jashtë shtetit jo-domosdoshmërisht ka të bëjë me jehonën e votuesve, dhe ajo është e

³ Më 9 nëntor, [Raporti i Bashkimit Evropian \(BE\) për Politikë të Zgjerimit](#) shënon se “vendi është ballafaquar me vazhdim të krizës më të rëndë politike që nga viti 2001. Demokracia dhe sundimi i ligjit sfidohen vazhdimisht, në veçanti për shkak të kapjes së shtetit i cili ndikon në funksionimin e institucioneve demokratike dhe fushave kryesore të shoqërisë. Vendi vuan nga një kulturë ndarëse politike dhe nga mungesa e aftësive për kompromis”.

⁴ Katër partitë më të mëdha parlamentare firmosën [Marrëveshjen e Përzghinos](#) dhe [Protokollin](#), që ftojnë për implementim të një seti të masave gjithëpërfshirëse për zgjidhjen e krizës politike, përfshi reformat zgjedhore dhe në media.

⁵ Një javë para vendimit final të gjykatës, parlamenti u mbledh sërish dhe votoi për anulimin e zgjedhjeve të 5 qershorit.

⁶ Shih [Marrëveshjen e 20 korrikut](#).

kushtëzuar me prapun që lidhet me zgjedhjet e mëparshme.⁷ Në këto zgjedhje nuk kishte deputetë të zgjedhur në njësinë zgjedhore jashtë shtetit.

Edhe pse obligimet dhe standardet ndërkombëtare nuk imponojnë ndonjë model specifik të sistemit zgjedhor, sistemi aktual nuk siguroi përfaqësimin parlamentar të votuesve nga njësia zgjedhore jashtë shtetit.⁸

Mund të merret parasysh rishikimi i praput për njësinë zgjedhore jashtë shtetit me qëllim që të sigurohet përfaqësimi parlamentar i këtyre votuesve, i cili mund të jetë në raport proporcional me jehonën e votuesve sikur që është rasti me votuesit e njësisve votuese brenda vendit.

Kodi Zgjedhor lejon devijime deri më pesë për qind nga numri mesatar i votuesve të regjistruar për njësitë zgjedhore brenda shtetit.⁹ Megjithatë, Kodi Zgjedhor nuk siguron metodë të qartë për de-limitimin e zonës zgjedhore përfshi procedurat e vendimmarrjes për të vendosur për kufijtë.¹⁰

Legjislacioni duhet të parashihet rishikim periodik të kufijve të njësisve zgjedhore të bërë nga ana e një organi të pavarur duke u bazuar në ndryshimet e numrit të popullatës. Kur të bëhet ridefinimi i kufijve të njësisve zgjedhore, ai duhet bërë në mënyrë transparente, të paanshme dhe përfshirëse.

Më 25 tetor, partia Uniteti sfidoi mbajtjen e zgjedhjeve në Gjykatën Kushtetuese me që numri i votuesve të regjistruar në njësinë zgjedhore numër 6 devijonte deri për 5.65 për qind nga numri mesatar. Gjykata nuk vendosi për këtë çështje para ditës së zgjedhjeve, por as në kohën e shkrimit të raportit.

V. KORNIZA LIGJORE

Zgjedhjet parlamentare përcaktohen nga Kushtetuta, Kodi Zgjedhor, Ligji për Partitë Politike, Ligji për Financimin e Partive Politike, dispozitat e Kodit Penal, Ligji për Mediat, dhe Ligji për Shërbimet Mediale Audio dhe Audiovizuale të cilat plotësohen me rregulloret e shpallura nga KSHZ.

Korniza ligjore në përgjithësi është e favorshme për të realizuar zgjedhje demokratike. Në aspekt pozitiv, legjislacioni zgjedhor është ndryshuar në mënyrë domethënëse në vitin 2015 si rezultat i Marrëveshjes së Përzihos kur amendamentet adresuan shumë rekomandime të mëparshme të OSBE/ODIHR dhe të Komisionit të Venecias posaçërisht ato në lidhje me parimet e të drejtës së

⁷ Një kandidat zgjidhet nga një njësi zgjedhore jashtë vendit nëse lista fiton së paku numrin e votave që është i barabartë me numrin e votave të fituara nga deputeti i zgjedhur në njësi zgjedhore në vend me numrin më të vogël të votave gjatë zgjedhjeve të mëparshme; për zgjedhjet e vitit 2016 numri i votave ishte 6,478. Kandidati i dytë dhe i tretë zgjidhen nëse lista e tyre fiton dy, respektivisht tre herë më shumë vota.

⁸ Paragrafi 21 i Komentit të Përgjithshëm Nr. 25 i Komitetit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (CCPR) i vitit 1996 për Nenin 25 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejta Civile dhe Politike (ICCPR) thotë “Edhe pse Pakti nuk imponon ndonjë sistem të caktuar zgjedhor, cilido sistem që funksionon në një Shtet duhet të jetë në pajtim me të drejtat e mbrojtura me Nenin 25 dhe duhet të garantojë dhe të ketë efekt në shprehjen e lirë të vullnetit të zgjedhësve”. Shih gjithashtu pjesën II.4 të [Kodit i Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore](#) i Komisionit të Venecias i Këshillit të Evropës të vitit 2002.

⁹ Pjesa I.2.2.iv [Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore i Komisionit të Venecias](#) i vitit 2002 rekomandon që mandatet të shpërndahen në mënyrë të barabartë mes njësisve zgjedhore me “Devijim të lejueshëm nga norma që nuk duhet të jetë më shumë se 10%, dhe kurrsesi nuk duhet të jetë më i lartë se 15% me përjashtim të rrethanave të veçanta (mbrojtja e një minoriteti të përqendruar, njësi administrative me dendësi të ulet të popullatës)..

¹⁰ Pjesa I.2.2.v e Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore i Komisionit të Venecias i vitit 2002 rekomandon që “me qëllim që të garantohej fuqia e barabartë e votës, shpërndarja e mandateve duhet të rishikohet të paktën çdo 10 vjet, dhe mundësisht jo gjatë periudhave zgjedhore”. Pjesa I.2.2.vii rekomandon që kjo të bëhet “në mënyrë të paanshme; jo në dëm të pakicave kombëtare; (dhe) duke marrë parasysh opinionin e një komisioni, shumica e anëtarëve e të cilit duhet të jenë të pavarur...”.

barabartë për votim jashtë shtetit, përbërjen dhe kompetencat e KSHZ-së, dhe masat për mbulim mediatik të balancuar gjatë fushatës. Ndryshimet gjithashtu përforcuan dispozitat për ndarjen e partisë nga shteti dhe raportimi mbi financimin e fushatës. Gjithashtu, votuesve iu është garantuar e drejta për dorëzim të ankesave gjatë cilësdo fazë të procesit zgjedhor dhe gjykatat obligohen të vendosin për kontestet zgjedhore brenda afateve më të shkurta kohore.¹¹

Sipas marrëveshjes së Korrikut 2016, me amendamente plotësuese u formua Komisioni i Përkohshëm dhe mbikëqyrjen e mediave dhe u vendos obligimi për qytetarët me të dhëna “të diskutueshme” në Listën e votuesve që të ri-regjistrohen në mënyrë aktive për këto zgjedhje.¹² Këto dispozita ishin të zbatueshme vetëm për zgjedhjet e vitit 2016 duke përcjellë sinjale për nevojën e reformës së vazhdueshme për trajtimin e këtyre çështjeve në një mënyrë më të qëndrueshme.

Pavarësisht përmirësimeve të bëra në Kodin Zgjedhor, një numër i problemeve të vjetra ngelin të pa trajtuara përfshi të drejtën për votim të qytetarëve pa vendbanim të përhershëm në vend, regjistrimi i kandidatëve, procedurat për tërheqjen e kandidatëve dhe listave, rishikimi publik dhe periodik i kufijve të njësive zgjedhore nga ana e një organi të pavarur. Veç kësaj, disa nene janë të dykuptimshëm ose bien ndesh me ligje dhe rregulla tjera, duke bërë të pasigurt zbatimin e tyre.¹³ Po ashtu, ndryshimet ligjore janë aprovuar me ngut nga parlamenti pas një procesi të reformave të cilit i mungonte transparenca dhe konsultimet kuptimplota me palët e prekura jashtë katër partive kryesore, përfshi institucionet relevante shtetërore, partitë tjera politike dhe shoqërinë civile. Kjo është në kundërshtim me angazhimet e OSBE-së.¹⁴

Siç është rekomanduar më parë, Kodi Zgjedhor do të përfitonte shumë nga një rishikim i plotë me qëllim të harmonizimit të tij të brendshëm dhe me ligjet tjerë relevant. Rishikimi duhet kryer në një procedurë publike pas konsultimeve mes aktorëve politik dhe përfaqësuesve relevant të shoqërisë civile.

VI. ADMINISTRIMI I ZGJEDHJEVE

Zgjedhjet e parakohshme parlamentare u administruan nga KSHZ-ja, 80 Komisioneve Komunale Zgjedhore (KKZ), 3,480 Këshilla Zgjedhorë (KZ) të formuar në tërë vendin dhe 46 KZ në përfaqësitë diplomatike-konsullate jashtë shtetit për votim jashtë vendit.

KSHZ-ja është organ i përhershëm përgjegjës për realizimin e përgjithshëm të zgjedhjeve. Organi është i emëruar nga parlamenti me mandat pesëvjeçar dhe përbëhet nga nëntë anëtarë: tre të propozuar nga partitë parlamentare qeverisëse, tre nga partitë opozitare dhe tre ekspertë të pavarur të zgjedhur në një konkurs të hapur. Kryetari dhe zëvendësi zgjidhen prej anëtarëve të pavarur. KSHZ-ja ka 34 zyra të përhershme dhe 17 zyra të përkohshme rajonale. Në pajtim me rekomandimet e mëparshme të

¹¹ Shih [Opinionin e Përbashkët të OSBE/ODIHR dhe Komisionit të Venecias mbi Kodin Zgjedhor të vitit 2016](#).

¹² Pjesa II.2.b e [Kodit të Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore i Komisionit të Venecias](#) i vitit 2002 rekomandon që “elementet themelore të ligjit zgjedhor...nuk duhet ti nënshtrohen ndryshimeve më pak se një vit përpara zgjedhjeve”. Megjithatë, përcjellja e rekomandimeve konsiderohet si një përjashtim nga parimi i stabilitetit të ligjit zgjedhor. Shih pjesën II.2 të [deklaratës interpretuese](#) për stabilitetin e ligjit zgjedhor.

¹³ Dispozita kundërtëuese mund të gjenden në Nenin 150 (2) të Kodit Zgjedhor i cili siguron zbulimin publik të mënyrës se si ka votuar secili prej gjykatësve gjatë shqyrtimit të apeleve lidhur me vendimet e KSHZ-së për anulimin e rezultateve zgjedhore. Për dallim nga kjo, Rregullorja për Procedurat e Gjykatave parasheh që procesverbalet e diskutimeve dhe votimit duhet të mbyllen dhe të vulosen në zarf të veçantë dhe nuk duhet të zbulohen në publik. Veç kësaj, Neni 31 (2) 34-g i Kodit Zgjedhor parasheh që në rast se anëtarët e KSHZ-së nuk arrijnë konsensus gjatë miratimit të propozim vendimit që ka të bëjë me interesat e një komuniteti jo-shumicë, mund të dorëzohet një ankesë në Gjykatën Administrative. Për dallim, sipas procedurave administrative, vetëm vendimet e KSHZ-së, jo edhe propozim vendimet, mund të apelojnë në Gjykatën Administrative.

¹⁴ Paragrafi 5.8 i [Dokumentit të Kopenhagës i OSBE-së i vitit 1990](#) përcakton se legjislacioni duhet “të miratohet pas mbarimit të procedurës publike”.

OSBE/ODIHR, resurset e KSHZ-së janë përforcuar me rekrutimin plotësues të personelit të përkohshëm në repartin juridik dhe sektorin e teknologjisë informatike.¹⁵

Siç është rekomanduar më parë, për të siguruar qëndrueshmëri të kapacitetit administrativ të KSHZ-së të gjitha pozitat esenciale mbështetëse duhet të jenë të përhershme, dhe kjo të bëhet përmes një procesi të hapur dhe konkurrues të rekrutimit.

Përgatitjet e KSHZ-së për këto zgjedhje u vështirësuan nga organizimi joefikas i brendshëm dhe nga vendimmarrja e politizuar. Afati i shkurtuar për zgjedhjet e parakohshme gjithashtu ka ndikuar negativisht në aktivitetet e KSHZ-së.¹⁶ Përderisa të gjitha përgatitjet përfunduan deri në ditën e zgjedhjeve, KSHZ-ja huqi disa afate kohore të rëndësishëm siç është dërgimi i Listës së votuesve tek partitë politike, mbyllja e Listës së votuesve, publikimi i listave të kandidatëve, dhe shpërndarja e materialeve zgjedhor deri tek KKZ-të dhe KZ-të.

Duhet të merret në konsideratë revidimi i Rregullave të Procedurës të KSHZ-së me qëllim të përmirësimit të organizimit të brendshëm, efikasitetit dhe transparencës në punë.

Vendimet e KSHZ-së në përgjithësi u aprovuan njëzëri. Megjithatë, për çështjet politikisht të diskutueshme anëtarët votuan sipas linjave të tyre partiake dhe shpesh u futën në diskutime të gjata procedurale ku kishte edhe shkëmbime të ndërsjella të nxehta lidhur me interpretimet e ligjit. Nganjëherë, vendimet ishin pastër partiake. Për shembull, KSHZ-ja caktoi renditjen e listave të kandidatëve në fletëvotime me anë të shortit, mirëpo listat i ndanë në dy grupe ku vendet e para në fletëvotim u ofruan katër partive parlamentare të përfaqësuara në KSHZ.¹⁷ Edhe pse askush prej garuesve nuk u ankua për këtë çështje, ky vendim diskriminoi garuesit e tjerë, dhe është në kundërshtim me angazhimet e OSBE-së dhe me standardet e Këshillit të Evropës.¹⁸

KSHZ-ja mbajti mbledhje të rregullta. Edhe pse seancat zyrtare ishin të hapura për vëzhguesit dhe për mediat, KSHZ-ja shpesh mbante seanca pune të fshehta në të cilat paraprakisht merreshin vesh për çështje substanciale për të cilat duhej vendosur në seanca publike.¹⁹ Anëtarët e Komisionit, kandidatët dhe përfaqësuesit njoftoheshin para mbajtjes së seancave të KSHZ-së, mirëpo në faqen e internetit nuk u publikuan të gjithë vendimet dhe procesverbalet, ashtu siç e kërkon ligji. Këto praktika e zvogëluan transparencën e punës së KSHZ-së.²⁰

¹⁵ Meqë mandati i punësimit të tyre skadoi më 31 dhjetor 2016, KSHZ kërkoi që këto kontrata të vazhdoen deri në prill 2017.

¹⁶ Kodi Zgjedhor përcakton se afatet për aktivitetet për zgjedhjet e parakohshme parlamentare janë pesë ditë më të shkurta se për zgjedhjet e rregullta, me përjashtim të gjatësisë së fushatës zgjedhore.

¹⁷ Katër pozitat në fletëvotime ishin sipas kësaj renditjeje: koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE, PDSH, BDI dhe koalicioni i udhëhequr nga LSDM. Vendimi i KSHZ-së për mënyrën e tërheqjes së shortit nuk u publikua.

¹⁸ Paragrafi 7.6 i [Dokumentit të Kopenhagës i OSBE-së i vitit 1990](#) obligon Shtetet pjesëmarrëse të sigurojnë “garancitë e nevojshme juridike për partitë dhe organizatat politike që të iu mundësohet atyre të garojnë me njëri tjetrin në bazë të trajtimit të barabartë të tyre para ligjit”. Gjithashtu shih pjesën 2.3 të [Kodit të Praktikës së Mirë të Komisionit të Venecias të vitit 2002](#). Neni 6 i Ligjit Kundër Diskriminimit përkufizon sjelljen diskriminuese si çdo “sjellje aktive dhe pasive e autoriteteve publike ... që krijon bazë për dhënie të privilegjeve ose vendosje të personave/subjekteve në kushte të pafavorshme”.

¹⁹ Kjo përfshinë vendimet për procedurat tenderuese për zgjedhjen e kontraktuesve për aktivitetet lidhur me shtypjen e materialeve zgjedhorë. Softueri IT për rezultatet e zgjedhjeve, transporti i anëtarëve të KZ në vendvotimet jashtë vendit dhe shërbimet për edukim të votuesve. Dokumentacioni i tenderimit nuk është bërë publik.

²⁰ Paragrafi 19 i [Komentit të Përgjithshëm Nr. 34 të Komitetit të KB për të Drejtat e Njeriut i vitit 2011](#) për Nenin 19 të [ICCCPR](#) thotë “Për tu realizuar e drejta për qasje në informacion, Shtetet pjesëmarrëse duhet në mënyrë proaktive të shpallin në faqe interneti informacionet Qeveritare me interes publik. Shtetet pjesëmarrëse duhet të bëjnë të gjitha përpjekjet për të siguruar qasje të lehtë, të shpejtë, efektive, dhe praktike në informacionet e tilla”. Shih gjithashtu Nenin 10 Konventës së Kombeve të Bashkuar kundër Korrupsionit e vitit 2003 (UNCAC).

Siç është rekomanduar më parë, me qëllim të rritjes së transparencës dhe besimit të publikut në punën e saj, të gjitha seancat e KSHZ-së duhet të jenë të hapura për publikun. Procesverbalet e seancave dhe vendimet e KSHZ-së duhet të publikohen në faqen e saj të internetit rregullisht dhe pa asnjë vonesë.

KSHZ ka për detyrë të mundësojë zbatim uniform të Kodit Zgjedhor, megjithatë ai nuk ndërmori hapat e nevojshëm për sqarimin e procedurave të caktuara të cilat nuk janë të përpunuara në Kod.²¹ Mungesa e qartësisë kontribuoi në zbatim jo konsekuent të procedurave nga ana e komisioneve zgjedhore, përfshi këtu edhe ditën e zgjedhjeve. Në çështjet tjera KSHZ-ja i tejkaloi kompetencat e veta, për shembull në instruksionet si votuesit mund të shënonin fletëvotimet e tyre dhe cili është fletëvotim i vlefshëm dhe cili është i pavlefshëm.²² Ky konfuzion, i kombinuar me mungesën e edukimit të votuesit për mënyrën e shënimit të fletëvotimit kontribuoi për numrin e lartë të fletëvotimeve të pavlefshme.

KSHZ duhet në kohë të qartësojë të gjitha procedurat e papërpunuara nga Kodi Zgjedhor. Të gjitha qartësimet duhet të jenë në përputhje me dispozitat e Kodit Zgjedhor.

Komisionet e niveleve më të ulëta në përgjithësi kanë punuar në mënyrë profesionale dhe transparente. KKZ-të janë përgjegjës për administrimin e zgjedhjeve në komunat e tyre përkatëse. Ato përbëhen nga pesë nëpunës publik të zgjedhur sipas rastit dhe zëvendësit e tyre, të emëruar me mandat pesëvjeçar. KZ-të përbëhen nga tre nëpunës publikë të zgjedhur sipas rastit, një anëtar i emëruar nga partia qeverisëse dhe një anëtar të emëruar nga partitë opozitare me një mandat katërvjeçar. Kodi parasheh përfaqësim të drejtë të grupeve etnike dhe gjinive në organet e administrimit të zgjedhjeve, si dhe sigurimin e materialeve zgjedhorë në gjuhët e pakicave.²³ Pavarësisht nga disa ndryshime të fundit në përbërjen e KKZ-ve dhe të KZ-ve, kriteri për përfaqësim të balancuar etnik dhe gjinor në komisionet zgjedhore u respektua në masë të gjerë. Megjithatë, vetëm dy nga nëntë anëtarët e KSHZ-së janë gra.

MVZ-ja e OSBE/ODIHR vërejti se disa KKZ kishin mungesë të hapësirave dhe pajisjeve adekuate.²⁴ Një numër i KKZ-ve informuan MVZ-në e OSBE/ODIHR se ata nuk kishin marrë në kohë fondet e nevojshme për administrim të zgjedhjeve dhe disa KKZ funksionin me fondet e tyre personale. Megjithatë, mungesa e fondeve nuk e pengoi përgatitjen e zgjedhjeve.

KSHZ-ja organizoi trajnime në të gjithë nivelet dhe përpiloi programe për mësim elektronik, doracakë dhe video për komisionet zgjedhore. Trajnimet që i vëzhgoi MVZ-ja e OSBE/ODIHR u vlerësuan pozitivisht nga pjesëmarrësit dhe shoqëria civile. KKZ-ja organizoi trajnime të limituar për të gjithë KZ-të, kryesisht duke përdorur video për trajnim duke vazhduar me trajnim të veçantë për kryesuesit e KZ-ve me qëllim të qartësimin të aspekteve më të rëndësishme të procedurave të votimit. Mirëpo, doracakut për KZ-të mungoi në shumë trajnime të KZ-ve dhe disa KKZ raportuan se doracakët ishin shpërndarë së bashku me materialet zgjedhorë, vetëm një ditë para ditës së zgjedhjeve.

²¹ Procedurat të cilat do të mund të përfitonin nga sqarimet për mënyrën e vendosjes së kabinave për votim për sigurimin e fshehtësisë së votës; mospërputhshmëria e gjetur mes fotografive në dokumentin e identifikimit të votuesit dhe në listën e votuesve; rinumërimi i fletëvotimeve nga KKZ-të dhe nga KSHZ-ja; vlefshmëria e fletëvotimeve; dhe vulosja e materialeve të ndjeshëm zgjedhorë nga ana e KZ-ve për t'u dorëzuar në KKZ.

²² Kodi Zgjedhor parasheh që fletëvotimi është i vlefshëm nëse është i shënuar me rrethim të numrit rendor të garuesit. Mirëpo, instruksionet e dhëna nga KSHZ sigurojnë se një fletëvotim është gjithashtu i vlefshëm nëse emri i kandidatit të parë ose simboli i garuesit është i rrethuar dhe se një fletëvotim është i pavlefshëm nëse i tëri ose pjesë e tij është i shënuar me kryq, nëse numri i fletëvotimit nuk përputhet me numrin e vendvotimit përkatës, ose nëse fletëvotimi nuk është i vulosur nga KZ-ja. Po ashtu, doracakut për KZ-të thotë se fletëvotimi nuk është i vlefshëm nëse është i shënuar me stilolaps me ngjyrë tjetër përveç ngjyrës blu.

²³ Në komunat ku komunitetet etnike përbëjnë së paku 20 për qind të popullatës, ato duhet të jenë të përfaqësuar në KKZ dhe KZ dhe të gjithë formularët dhe materialet zgjedhorë përfshirë edhe fletëvotimet duhet gjithashtu të sigurohen në gjuhën e tyre. Në njësitë zgjedhore ku së paku 20 për qind të qytetarëve flasin një prej gjashtë gjuhëve të pakicave zyrtarisht të pranuar, lista e kandidatëve gjithashtu duhet të dorëzohet në këtë gjuhë. Së paku 30 për qind të anëtarëve të secilit trup zgjedhor duhet të jetë nga gjinia tjetër.

²⁴ Siç është vërejtur në Novo Sellë, Orizarë, Kumanovë, Tetovë, Tearcë, Gostivar, Vrapçishte, Mavrovë, Jegunoc, Zhelinë, Bërvenicë, Bogovinë dhe Kratovë.

KSHZ-ja duhet të merr në konsideratë sigurimin e trajnimeve më gjithëpërfshirës për komisionet e nivelit më të ulët me fokus në procedurat e ditës së zgjedhjeve.

KSHZ-ja organizoi fushatë të limituar për edukimin e votuesit. Gjithashtu formoi një linjë të hapur telefonike që qytetarët të raportojnë çfarëdo parregullsie gjatë ditës së zgjedhjeve. Në mënyrë pozitive një numër i organizatave të shoqërisë civile hartuan një fushatë për ndërgjegjësim të votuesve lidhur me fshehtësinë e votës dhe pjesëmarrjen e votuesit.

KSHZ-ja duhet të merr në konsideratë hartimin me kohë të një programi gjithëpërfshirës edukativ, gjithashtu edhe në gjuhët e pakicave kombëtare. Vëmendje e veçantë duhet kushtuar shënimit të fletëvotimeve nga ana e votuesve dhe fshehtësisë së votës.

VII. REGJISTRIMI I VOTUESVE

Regjistrimi i votuesit është pasiv me përjashtim të votuesve me vendbanim të përkohshëm jashtë vendit të cilët duhet patjetër të regjistrohen në mënyrë aktive. Sipas Kushtetutës, qytetarët që janë 18 vjeç në ditën e zgjedhjeve kanë të drejtë të votojnë përveç nëse janë të privuar nga cilësia e tyre juridike në bazë të një vendimi gjyqësor.²⁵ Megjithatë, vetëm votuesit me letërnjoftim të vlefshëm ose pasaportë biometrike dhe me vendbanim të regjistruar në vend, janë të përfshirë në Listën e votuesve. Këto kufizime janë në kundërshtim me dispozitën kushtetuese për të drejtën universale për votim e caktuar në paragrafin 7.3 në Dokumentit e Kopenhagës të OSBE-së të vitit 1990.²⁶ Veç kësaj, Kodi Zgjedhor përmban dispozita kundërtënëse në lidhje me të drejtën e votuesve në njësinë zgjedhore jashtë vendit.²⁷

Të gjithë votuesit me të drejtë vote duhet të shtohen në listat e votuesve pavarësisht vlefshmërisë së letërnjoftimeve apo pasaportave të tyre, ashtu siç e parasheh Kushtetuta.

KSHZ-ja është përgjegjëse për mirëmbajtjen dhe përditësimin e Listës së votuesve me informacione të marra katër herë në vit nga Ministria e punëve të brendshme (MPB) në bazë të bazës së të dhënave të qytetarëve me dokumente të vlefshme identifikimi dhe vendbanim të regjistruar. Po ashtu, Gjykatat Themelore i sigurojnë KSHZ-së listat e personave të privuar nga cilësia e tyre juridike.

Në bazë të Marrëveshjes së Përzhinos, me qëllim të adresimit të mosbesimit të vjetër në saktësinë e listave të votuesve, KSHZ-së iu dha për detyrë të rishikojë regjistrin e votuesve. Ai bëri kontroll të kryqëzuar të të dhënave në regjistër duke i krahasuar me bazat e të dhënave nga 11 institucione

²⁵ Neni 24 i Kushtetutës thotë se “të drejtat dhe liritë e garantuara të njeriut mund të kufizohen vetëm me ligj brenda sferës të lejuar nga Kushtetuta [...]”. Privimi nga e drejta për votë në bazë të paafësisë mendore është në mospërputhje me Nenet 12 dhe 29 nga [Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara \(CRPD\) e vitit 2006](#). Shih gjithashtu paragrafin 9.4 të 2013 Komunikatës Nr 4/2011 të Komisionit të CRPD (*Zsold Bujdosos dhe pesë të tjerë kundër Hungarisë*) e cila thotë se: “Neni 29 nuk parasheh ndonjë kufizim të arsyeshëm, as ndonjë përjashtim për ndonjë grup të personave me aftësi të kufizuara. Prandaj, përjashtimi nga e drejta për votë në bazë të paafësisë të perceptuar ose aktuale psikologjike ose intelektuale përfshi kufizimin sipas vlerësimit të individualizuar, përfaqëson diskriminim në bazë të aftësisë së kufizuar, brenda kuptimit të Nenet 2 të Konventës”.

²⁶ Paragrafi 7.3 i [Dokumentit të Kopenhagës i OSBE-së i vitit 1990](#) angazhon Shtetet pjesëmarrëse të “garantojnë të drejtë universale dhe të barabartë për votim për qytetarët e moshës madhore”. Shih gjithashtu pjesët I.1.1 dhe I.1.2 të [Kodit të Praktikës së Mirë të Komisionit të Venecias të vitit 2002](#). Neni 22 i Kushtetutës siguron se “Çdo qytetar me mbushjen e moshës 18 vjeçare fiton të drejtën për votim. E drejta për votim është e barabartë, universale dhe e drejtpërdrejtë dhe realizohet në zgjedhje të lira me anë të votës së fshehtë.”

²⁷ Neni 41(4) thotë se vetëm votuesit me vendbanim në vend shënohen në Listën e votuesve. Neni 6(1) parasheh që çdo qytetar me “vendbanim në njësinë zgjedhore” ka të drejtë për votim, që përfshinë edhe qytetarët në njësinë zgjedhore jashtë vendit.

shtetërore, dhe që u përcjell edhe me kontrole në terren.²⁸ Mirëpo KSHZ-ja nuk mundi të kontrollojë vlefshmërinë e të dhënave të marra nga institucionet shtetërore meqë nuk kishte qasje të drejtpërdrejtë në bazat e të dhënave dhe të dokumenteve të tyre.

Procesi i rishikimit i cili vëzhgohej nga katër partitë kryesore politike rezultoi me një numër të limituar të fshirjeve, kryesisht të personave të vdekur. Veç kësaj, 39,502 votues ishin identifikuar me të dhëna për “regjistrim të diskutueshëm” dhe u obliguan që të ri-regjistrohen, dhe 171,500 votues u konsideruan me vendbanim të përkohshëm jashtë vendit dhe u vendosën në një listë të veçantë të votuesve jashtë vendit.²⁹ Këta të fundit ende kishin mundësinë të votojnë në vend në adresat e tyre të regjistruara për herë të fundit. Përderisa procesi në njëfarë mënyre përmirësoi saktësinë e Listës së votuesve, ai privoi një numër të votuesve nga mundësia për të votuar. Më 13 nëntor, KSHZ-ja vendosi të fshijë 28,341 emra nga lista. Në kundërshtim me standardet ndërkombëtare dhe praktikës së mirë, votuesit nuk kishin mundësinë të ankohen dhe të shënohen në listat votuese.³⁰

Duhet të vendoset një mekanizëm për korrigjim me kohë dhe efektiv për të gjithë qytetarët me të drejtë vote të cilët nuk u gjetën në Listën e votuesve me qëllim që ata të mund të realizojnë të drejtën e tyre për votë.

Për këto zgjedhje, votuesit kishin mundësinë të kontrollojnë dhe të ndryshojnë të dhënat e tyre të regjistrimit në zyrat rajonale të KSHZ-së gjatë periudhës të caktuar për shqyrtim publik prej 28 tetor deri në 11 nëntor. Edhe pse obligim ligjor, zyrat rajonale të KSHZ-së nuk shpallën lista të shtypura të votuesve dhe votuesit të cilët vizituan zyrat nuk kishin mundësi të kontrollojnë të dhënat e tyre në kompjuterët e KSHZ-së. Votuesit mundeshin të kontrollojnë të dhënat e tyre personale vetëm në internet si dhe të kontrollojnë emrat e atyre që ishin regjistruar në adresa tjera. Sipas KSHZ-së, pak nga gjithsej 10,274 votues të cilët vizituan zyrat e KSHZ-së kërkuan të bëhen korrigjime.³¹ Votuesit të cilët përkohësisht banojnë jashtë komunave të tyre siç janë studentët, personat me punësim të përkohshëm, ushtria, ose pacientët në spitale, mund të votonin vetëm nëse udhëtonin në shtëpitë e tyre të banimit të përhershëm.

Shqyrtimi i Listës së votuesve ishte i zbatueshëm vetëm për këto zgjedhje. Të metat ligjore dhe strukturore për mirëmbajtjen e Listës së votuesve nuk u adresuan. Sipas Kodit Zgjedhor, vetëm qytetarët me banim të përhershëm të regjistruar në vend mund të futen në regjistrin e votuesve. Megjithatë, MVZ-ja e OSBE/ODIHR u informua se votuesit futen në regjistrin e votuesve edhe në bazë të banimit të tyre të përkohshëm, ose nganjëherë në bazë të adresës ku kanë lindur. MPB-ja nuk mirëmban të dhëna konsekuente për të dy kategoritë e adresave – banim të përkohshëm dhe vendbanim të përhershëm.³² Në bazë të një deklaratë të thjeshtë qytetarët mund të regjistrohen në një adresë të

²⁸ Kontrollat në terren u mbajtën prej 28 mars deri 6 prill. Më 26 prill, KSHZ-ja raportoi se ishin identifikuar 44,308 votues në adresa me më shumë se 20 persona, dhe disa me më shumë se 6 mbiemra.

²⁹ Më 23 korrik, në Nenin 196 të Kodit Zgjedhor u shtuan dispozita për të përkufizuar këto dy kategori të votuesve. Votuesit pa të dhëna aktive në bazat e të dhënave të institucioneve tjera pas 1 korrikut të vitit 2015 u konsideruan se jetojnë jashtë vendit, derisa ata pa të dhëna të gjetura në bazat e të dhënave përveç se në regjistrin e MPB-së, dhe të cilët nuk u gjetën në shtëpi gjatë kontrollit në terren, u obliguan të ri-regjistrohen. 1 korriku 2015 si datë prerëse nuk u mor si referencë në asnjë dokument ligjor, dhe u vendos nga KSHZ-ja si pasojë e marrëveshjeve politike.

³⁰ Neni 7.3 i [Dokumentit të Kopenhagës i OSBE-së i vitit 1990](#), Neni 25(b) i [ICCPR-së](#), paragrafët 3 dhe 11 të 1996 [Komentit të Përgjithshëm Nr.25 i CPPR të KB të vitit 1996](#). Sipas pjesës I.1.2.iv në [Kodin e Praktikës së Mirë të Komisionit të Venecias të vitit 2002](#). “duhet të ketë procedurë administrative – objekt i kontrollit gjyqësor – ose procedurës gjyqësore, që lejon regjistrimin e votuesit të peregjistruar; regjistrimi nuk duhet të bëhet në vendvotim në ditën e zgjedhjeve”.

³¹ Si rezultat i kësaj, u bënë 176 ndryshime, 88 persona u shtuan dhe 71 u fshinë për shkak të adresës së gabuar ose vdekjes.

³² Vendbanimi i përhershëm dhe i përkohshëm janë të përkufizuar me Ligjin për Vendbanim të Përhershëm dhe të Përkohshëm në Nenet 2 dhe 4, gjegjësisht. Vendbanimi i përkohshëm regjistrohet në bazë të deklaratimit personal ndërsa vendbanimi i përhershëm regjistrohet në bazë të pronësisë ose kontratës juridikisht të regjistruar për qiramarrje.

përkohshme në vend dhe të ju lejohet të votojnë aty, edhe pse ata nuk jetojnë në adresën e deklaruar, ose mund të mos kenë vendbanim të përhershëm në vend. Edhe pse dispozitat ligjore e obligojnë MPB-në të regjistrojë qytetarët të cilët kanë lëshuar vendin për më shumë se tre muaj dhe nuk e kanë deklaruar atë, dhe të bëjnë verifikimin e deklarimeve për adresat e përkohshme, aktiviteti proaktiv i MPB-së për përditësimin e regjistrit të adresave ishte i limituar.³³

Një problem strukturor plotësues është cilësia e regjistrit të adresave që kryesisht është për shkak të dhënave të mangëta për vdekjet, emrat e rrugëve gabimisht të shkruar ose që nuk ekzistojnë më, dhe mungesa e koordinimit efikas në mes agjencive përgjegjëse.

Sic u rekomandua më parë, KSHZ-ja dhe MPB-ja duhet të vazhdojnë me procesin e përditësimit të Listës së votuesve përmes përpjekjeve të koordinuara dhe sipas përgjegjësive dhe procedurave qartë të përkufizuara. Ky proces duhet të trajtojë problemet strukturore në një mënyrë të qëndrueshme, të jetë transparent, dhe të sigurojë qasje për partitë politike dhe shoqërinë civile.

Ligji për Banim të Përhershëm dhe të Përkohshëm duhet të korrigojë që të përcaktojë definicione të qëndrueshme për banimin e përkohshëm dhe të përhershëm të qytetarëve që jetojnë brenda dhe jashtë shtetit, si dhe mekanizma efikas për MPB-në për përditësim të regjistrit të adresave. Mospërputhjet ligjore duhet të trajtohen me qëllim që të sigurohet saktësi në regjistrimin e të dhënave të votuesve në bazë të vendit ku aktualisht banojnë qytetarët.

KSHZ-ja miratoi 20,573 dhe refuzoi 458 aplikacione për votim jashtë vendit.³⁴ Një numër aplikacionesh ishin dërguar nga e njëjta adresë e postës elektronike dhe një numër i konsiderueshëm nga adresa me protokoll të njëjtë të Internetit në Shkup, Manastir dhe Shtip. Disa bashkëbisedues të MVZ-së së OSBE/ODIHR ngritën dyshime për integritetin e procesit. Disa parti politike informuan MVZ-në e OSBE/ODIHR se ata kishin ndihmuar votuesit me aplikacionet e tyre. Votuesit obligoheshin të deklarojnë etninë e tyre që, sipas KSHZ-së, nevojitej për shtypjen e materialeve zgjedhorë në gjuhët e minoriteteve. Vetëm 8,229 votues jashtë vendit hodhën votën e tyre, gjë që mund të mbështesë shqetësimet për atë se ndoshta disa qytetarë u regjistruan nga partitë politike pa pëlqimin e tyre.³⁵

Me qëllim që të rritet besimi i publikut në këtë proces, duhet të ndërmerren masa për të siguruar që regjistrimi aktiv për votim jashtë vendit të kryhet vetëm nga ana e votuesit.

Më 18 nëntor, dy ditë pas afatit të fundit ligjor, KSHZ-ja furnizoi garuesit zgjedhorë me kopje të listës paraprake të votuesve. LSDM-ja kërkoi shtimin e 45 personave të cilët rishtazi kishin nxjerrë letërnjoftime të reja, shtimin e 348 votuesve të identifikuar përmes kontrollit në terren të bërë nga ana e vetë partisë dhe fshirjen e rreth 800 votuesve të cilët nuk u gjetën në adresat shtëpiake të tyre. BDI-ja kërkoi shtimin e pesë votuesve aplikacionet e të cilëve ishin vonuar nga zyrat rajonale të KSHZ-së.

³³ Sipas të dhënave të MPB-së, gjatë vitit 2016 vetëm 586 persona nga vendi kanë raportuar banim të përkohshëm jashtë vendit të banimit të tyre të përhershëm. Gjatë përtëritjes së letërnjoftimeve, pasaportave apo patentë shoferit, MPB-ja nuk bën verifikimin e dokumentacionit që dëshmon adresën e personit.

³⁴ Sipas KSHZ-së, nga 21 tetori, 76,721 votues kanë qenë me banim të përkohshëm jashtë vendit.

³⁵ Disa votues informuan OSBE/ODIHR se ata u pamundësuan të votojnë në vend sepse ata ishin regjistruar për të votuar jashtë vendit pa dijeninë apo pajtimin e tyre.

KSHZ-ja refuzoi kërkesat e LSDM-së dhe pranoi kërkesën e BDI-së.³⁶ KSHZ-ja po ashtu aprovoi 107 prej 120 fshirjeve të kërkuara nga organizatat e shoqërisë civile.³⁷

Si masë përforcuese për identifikimin e votuesit, për herë të parë, në Listën e votuesve u vendosën edhe fotografitë e votuesve. Megjithatë, KSHZ-ja nuk dha kurrfarë udhëzimesh për KZ-të për mënyrën se si të merren me rastet e mospërputhjes së fotografive nga Lista e votuesve me fotografinë në letërnjoftimet e prezantuara në ditën e zgjedhjeve.

Më 28 nëntor, dy ditë pas datës zyrtare për mbyllje të Listës së votuesve, KSHZ-ja njoftoi se 1,784,416 votues ishin të regjistruar për votim në vend, prej të cilëve 230,122 ishin vendosur në listë të veçantë të votuesve të cilët konsideroheshin se jetojnë përkohësisht jashtë vendit. Listë e veçantë është krijuar edhe për 2,015 të burgosur, për 13 persona të shpërngulur brenda vendit dhe për 325 anëtarë të KZ-ve jashtë vendit. Gjithsej u regjistruan 5,746 votues me postë prej të cilëve 999 u refuzuan, që përbëjnë 0.32 për qind të numrit të përgjithshëm të votuesve. Procedura e KSHZ-së për regjistrimin e votuesve me postë në bazë të aplikimit konsiderohej si restriktive dhe e paqartë nga ana e shumicës së KKZ-ve.

VIII. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE

Çdonjëri me të drejtë vote mund të jetë kandidat për në parlament, përveç atyre të dënuar me vendim gjyqësor përfundimtar me më së paku gjashtë muaj dhe që nuk e kanë vuajtur dënimin e tyre. Partitë politike, koalicionet e partive politike dhe grupe të votuesve të regjistruar mund të propozojnë kandidatë. Të fundit duhet të sigurojnë së paku 1,000 nënshkrime mbështetës nga votues me banim në njësitë përkatëse zgjedhore. Në pajtim me një rekomandim të mëparshëm të OSBE/ODIHR dhe Komisionit të Venecias, për herë të parë, një votues ka pasur mundësi të nënshkruajë mbështetje për më shumë se një listë të kandidatëve; megjithatë, ende kërkohet që nënshkrimet të grumbullohen para punonjësit të KSHZ-së. Asnjë grup i votuesve nuk bëri përpjekje për të regjistruar kandidatë.

Siç u rekomandua më parë, me qëllim që të zvogëlohet mundësia për frikësim, mund të merret në konsideratë sigurimi i metodave alternative për grumbullimin e nënshkrimeve ose lejimi i depozitimit të fondeve.

Regjistrimi i kandidatëve u bë prej 18 tetorit deri më 11 nëntor dhe ishte gjithëpërfshirës në përgjithësi. Megjithatë, dokumentacionin e nevojshëm për regjistrim të kandidatëve KSHZ-ja e publikoi vetëm më 1 nëntor. Procesi i regjistrimit u ndikua negativisht po ashtu edhe nga mungesa e qartësisë ligjore në disa aspekte të propozimit dhe regjistrimit, përfshi këtu edhe verifikimin e nënshkrimit dhe ri-dorëzimit të dokumenteve për regjistrim, si dhe nga një qasje kontradiktore të KSHZ-së në verifikimin e dokumentacionit.³⁸ Kjo rezultoi me refuzimin e një numri të listave të Partisë Social Demokrate të Maqedonisë (PSDM) dhe të Lëvizjes Popullore për Maqedoni (LPM).³⁹ KSHZ shfrytëzoi kompetencat

³⁶ KSHZ-ja justifikoi vendimin e saj me arsyet se votuesit do të mund të futeshin në Listën e votuesve vetëm në bazë të aplikimit personal. Kjo është në kundërshtim me Nenin 49-a të Kodit Zgjedhor i cili lejon partitë të kërkojnë “futje të të dhënave” në Listë. KSHZ-ja gjithashtu konsideron se LSDM-ja nuk mund të shfrytëzojë kontrollet e veta në terren si bazë për heqjen e votuesve nga Lista, dhe është dashur që të bazojë kërkesën e vet vetëm në informatat ekzistuese nga regjistri paraprak.

³⁷ Zyra vendore e Transparency International kërkoi nga KSHZ-ja të fshijë 120 votues me vendbanim të përhershëm në godinën e Ministrisë për Punë të Brendshme (MPB). MPB-ja anuloi 107 të dhëna për shkak të regjistrimit të paligjshëm.

³⁸ Megjithëse nuk ishte çështje në këto zgjedhje, ligji është po ashtu i paqartë sa i përket kushteve për tërheqjen dhe zëvendësimin e kandidatëve në lista.

³⁹ KSHZ-ja njoftoi partitë për të korigjuar një numër të parregullsive dhe lëshimeve përfshirë edhe certifikatat e gjendjes gjyqësore dhe deklaratat e nënshkruara që vërtetojnë etninë, njësinë zgjedhore dhe pranimin e kandidaturës. Megjithatë, KSHZ-ja në fund refuzoi të gjitha listat, disa prej tyre për shkaqe të parregullsive jo të komunikuar fillimisht.

diskrecionale të saj në mënyrë kontradiktore gjatë verifikimit të nënshkrimeve dhe refuzoi listat pa njoftim paraprak, i cili do të lejonte korrigjime të caktuara. Dy partitë apeluan vendimet e KSHZ-së në Gjykatën Administrative e cila përkrahu vendimet e KSHZ-së.

Duhet të vendosen procedura të hollësishme dhe në kohë për shqyrtimin e listave të kandidatëve me qëllim që të sigurohet qëndrueshmëri dhe gjithpërfshirje e procesit të regjistrimit, përfshirë edhe dhënien e kohës së mjaftueshme për garuesit që të korrigjojnë parregullsitë. Një rishikim i Kodit Zgjedhor mund të konsiderojë specifikimin e të gjitha kushteve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për tërheqjen dhe zëvendësimin e listave të kandidatëve.

KSHZ-ja regjistroi 6 parti politike dhe 5 koalicione me gjithsej 1,092 kandidatë në 58 lista.⁴⁰ Në përputhje me kuotën e ndryshuar me qëllim që të rritet pjesëmarrja e grave, 41 për qind të kandidatëve ishin gra.⁴¹ Megjithatë, vetëm 4 prej 58 listave ishin të kryesuara nga gratë, the për këtë një numër i bashkëbiseduesve të MVZ-së të OSBE/ODIHR u shprehën se partitë politike duhet të bëjnë më shumë përpjekje për promovimin e kandidatëve gra. KSHZ-ja regjistroi për zgjedhje jashtë vendit listën e kandidatëve të Organizatës së Brendshme Revolucionare Maqedonase-Partia Popullore (VMRO-PP) dhe për zgjedhje brenda vendit dy lista të *Levica* edhe pse nuk përmbushnin kushtin e përfaqësimit gjinor. U zgjodhën 38 gra (31.6 për qind), 4 më pak se në parlamentin e mëparshëm.⁴²

Partitë duhet të konsiderojnë masa të brendshme për avancimin e grave në pozita më të larta brenda strukturave partiake, dhe përfshirjen e tyre në listat e kandidatëve në pozita me mundësi fituese.

IX. FUSHATA

Fushata zyrtare filloi më 21 nëntor dhe mbaroi me 24 orë heshtje para hapjes së vendvotimeve. Partitë politike dhe koalicionet filluan me fushatë para fillimit zyrtar të fushatës me vizitat e figurave udhëheqëse politike duke mobilizuar votuesit e tyre në tërë vendin. Partitë në përgjithësi patën mundësi të bëjnë fushatë lirshëm dhe liritë themelore për bashkim, tubime dhe shprehje u respektuan. Fushata megjithatë u zhvillua në një mjedis të karakterizuar me mungesë të besimit të publikut në institucionet shtetërore dhe establishmentin politik.

Garuesit bënë fushatë të gjerë përmes mediave sociale si dhe me diskutime derë-më-derë, në takime të vogla dhe tubime.⁴³ Bilbordet ishin të dukshëm në shumë komuna dhe në përgjithësi u takonin katër partive më të mëdha. Mirëpo vendosja e pllakateve dhe banderolave në vendet publike dallonte mes komunave për shkak të lokacioneve të shënuara në mënyrë të paqartë dhe disa autoritete lokale nuk

⁴⁰ Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE “Për Maqedoni më të mirë” përfshinte 25 parti, dhe koalicioni i udhëhequr nga LSDM “Për jetë” përfshinte 14. Koalicionet e tjera ishin Aleanca për Shqiptarët (Lëvizja për Reforma-PDSH, Uniteti dhe RDK), Koalicioni për Ndryshim dhe Drejtësi (Unioni Demokratik, FRODEM, MORO – Partia e Punëtorëve, dhe DEMOS) dhe VMRO-Koalicioni për Maqedoni (VMRO-PP, Të Bashkuar për Maqedoni dhe *Dostoinstvo*). Gjashtë partitë e regjistruara ishin BDI, PDSH, BESA, *Levica*, Partia për Prosperitet Demokratik, dhe Partia Liberale. Një e treta e 123 deputetëve në largim nuk garuan në këto zgjedhje.

⁴¹ Çdo i treti dhe çdo i dhjeti kandidat në listë duhet të jetë nga gjinia më pak e përfaqësuar. Kuota u rrit për 10 për qind në krahasim me zgjedhjet e viti 2014.

⁴² Neni 7 i [Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Ndaj Grave \(CEDAW\)](#) thotë se “Shtetet pjesëmarrëse marrin të gjitha masat e përshtatshme për të eliminuar diskriminimin ndaj grave në jetën politike dhe publike të vendit dhe në mënyrë të veçantë u sigurojnë grave, në të njëjtat kushte me burrat, të drejtën: (a) Për të votuar në të gjitha zgjedhjet dhe referendimet publike, si dhe për të qenë me të drejtë për tu zgjedhur në të gjitha organet e zgjedhura publikisht”. Shih gjithashtu paragrafin 3 e Vendimit Ministror të OSBE-së të 7/09 i cili fton Shtetet pjesëmarrëse të promovojnë pjesëmarrje të barabartë të grave dhe meshkujve në partitë politike me synim të arritjes së përfaqësimit më të balancuar gjinor në të gjithë nivelet e vendimmarrjes në institucionet e zgjedhura publike”

⁴³ Në vend ka rreth 1 milion përdorues të Facebook.

ishin të vetëdijshëm për obligimet e tyre për caktimin e lokacioneve të tilla. Për shkak të kufizimeve financiare partitë e vogla gjatë fushatës kryesisht u mbështetën në mediat sociale.

Kishte pjesëmarrje të mirë në të gjitha tubimet e mbajtur gjithandej vendit edhe pse në disa mungoi entuziazmi i audiencës.⁴⁴ Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE përfitoi nga përkrahja publike e zyrtarëve të lartë nga shtetet anëtare të BE-së, përfshirë edhe në tubime. Gratë u përfaqësuan në audiencë mesatarisht me 20 për qind, ndërsa në tubimet e partive etnike shqiptare përqindja e grave është madje edhe më e vogël. Vetëm disa prej folësve në tubime ishin gra.

Porositë kryesore të fushatës përqendroheshin në ekonomi, migrimin e rinisë dhe krijimin e vendeve të punës. Përderisa shumica e garuesve zhvilluan fushatë pozitive, u vërejt edhe retorika negative. Koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE përdori porosi nacionaliste dhe akuzoi koalicionin e udhëhequr nga LSDM-ja për tentime për dobësim të identitetit kombëtar, duke i prezantuar zgjedhjet si një referendum për unitaritetin dhe sovranitetin e shtetit. Nga ana tjetër, koalicioni i udhëhequr nga LSDM-ja akuzoi koalicionin e udhëhequr nga VMRO-DPMNE për shpërdorim të pushtetit dhe aktivitete kriminale.

Fushata brenda komunitetit shqiptar ishte më e gjallë, me pak retorikë nxitëse nga PDSH, BESA, Aleanca për Shqiptarët dhe BDI. Biseda të përgjuara të reja të zyrtarëve të BDI-së u postuan në rrjetet sociale gjatë fushatës dhe të PDSH-së pas zgjedhjeve. Fushatat e partive etnike shqiptare iu drejtuan vetëm komunitetit të tyre dhe retorika nacionaliste u vërejt në disa tubime.

Pothuajse nuk kishte debate mes udhëheqësve politik apo kandidatëve që kryesonin listat në nivel të njëjësive zgjedhore ose në nivel shtetëror. Përjashtimi i vetëm ishte debati mes katër partive më të mëdha parlamentare (VMRO-DPMNE, LSDM, BDI dhe PDSH) në njësinë zgjedhore numër një në Shkup më datë 29 nëntor.

Gjatë fushatës u shënuan një numër i incidenteve të dhunshëm të cilët kishin në shënjestër disa parti politike.⁴⁵ Disa parti pretenduan se kishin vështirësi në hapjen e shtabeve të tyre për fushatë në disa zona të kontrolluara nga BDI-ja.⁴⁶ Pretendimet e vazhdueshme për frikësim të votuesve, përdorim force, trysni ndaj punonjësve publik, blerje votash në komunitetin Romë dhe keqpërdorim të resurseve administrative, ndikuan negativisht në fushatë. MVZ-ja e OSBE/ODIHR vërtetoi mbi dhjetë nga këto pretendime.⁴⁷ Veprimet e tilla ngritën shqetësime për mundësinë e votuesve të japin votën e tyre “pa frikë nga ndëshkimi”, siç kërkohet në paragrafin 7.7 të Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së i vitit 1990.⁴⁸

⁴⁴ MVZ-ja e OSBE/ODIHR vëzhgoi më shumë se 60 tubime në tërë vendin.

⁴⁵ Një numër i zyrave partiake lokale u dëmtuan ose u shkatërruan (LSDM Haraçinë më 7 nëntor; VMRO-DPMNE Kavadar më 18 dhe 26 nëntor; NSDP Aerodrom më 22 nëntor; dy zyra të VMRO-DPMNE në Negotinë më 23 nëntor; BDI Sllupcan më 25 nëntor). Më 9 nëntor iu vu zjarri veturës së kryetarit të degës së GROM në Strumicë; më 13 nëntor vetura e liderit të BDI-së u gjuajt me gurë nga një grup i banorëve lokal në Kumanovë. Disa bilborde u shkatërruan: i BDI-së në Kumanovë dhe Gjorçe Petrov; i BESA-ës në Saraj; i VMRO-DPMNE-së në Strumicë, Shtip, Kumanovë dhe Berovë. Pas zgjedhjeve, dy shtabe të LSDM-së u shkatërruan në Shkup dhe vetura e deputetit të mëparshëm të BDI-së u dëmtua dhe u përcollën kërcënime.

⁴⁶ BESA, PDSH dhe LSDM deklaruan vështirësi për hapjen e zyrave të partive në rajonin e Tetovës.

⁴⁷ Përfshirë denoncime për blerje të votës dhe presion të ushtruar ndaj individëve, familjeve të tyre, përfaqësuesve të pakicave kombëtare, të punësuarve publik dhe privat, dhe medias, kryesisht nga VMRO-DPMNE dhe BDI.

⁴⁸ Paragrafi 7.7 i [Dokumentit të Kopenhagës të OSBE-së i vitit 1990](#) angazhon Shtetet pjesëmarrëse të “sigurojnë që ligji dhe politika e punës publike të mundësojë mbajtjen e fushatës politike në atmosferë të drejtë dhe të lirë në të cilën as veprimet administrative, as dhuna e as frikësimi nuk ndalon partitë dhe kandidatët të prezantojnë lirshëm pikëpamjet dhe kualifikimet e tyre, ose ndalon votuesit të mësojnë apo të diskutojnë me ta, apo ndalon votuesit të hedhin votën e tyre lirshëm dhe pa frikë ndëshkimi”. Shih gjithashtu [Udhëzuesin e Përbashkët të Komisionit të Venecias të OSBE/ODIHR i vitit 2016 për Parandalimin dhe Reagimin ndaj Keqpërdorimit të Resurseve Administrative gjatë Procesit Zgjedhor](#).

Qytetarët, përfshirë edhe punonjësit publik, nuk duhet të jenë objekt i presionit apo frikësimit. Autoritetet dhe partitë politike duhet të marrin hapa më të vendosur që të sigurojnë të mos ushtrohet presion ndaj punonjësve të sektorit publik, aktivistëve politikë, apo personave të tjerë, për të marrë pjesë në aktivitetet e fushatës, apo për të votuar në një mënyrë të caktuar. Autoritetet duhet në kohë, tërësisht dhe në mënyrë efikase, të hetojnë dhe të ndjekin penalisht të gjitha rastet dhe pretendimet për presion dhe frikësim të ushtruar ndaj votuesve.

X. FINANCIMI I FUSHATËS

Kodi Zgjedhor rregullon financimin e fushatës. Siç kërkohet me ligj, garuesit në zgjedhje hapën llogari bankare të dedikuara për qëllim të financimit të fushatës. Individët mund të bënin donacion deri në 3,000 Euro, ndërsa personat juridik mund të bënin donacion deri në 30,000 Euro. Donacionet e huaja dhe anonime, si dhe ato nga organizatat në pronë të shtetit, fetare dhe humanitare, ishin të ndaluara. Garuesit mund të shpenzonin maksimum 1.8 Euro për çdo votues të regjistruar në njësinë zgjedhore. Listat kompensohen me 0.25 Euro për çdo votë të fituar, me kusht që të kenë marrë së paku 1.5 për qind të votave të hedhura në njësinë zgjedhore.

Garuesit duhet të dorëzojnë dy raporte të përkohshëm dhe një përfundimtar në KSHZ, në Entin Shtetëror për Auditim (ESHA) dhe në Komisionin Shtetëror për Parandalim të Korrupsionit (KSHPK). Të gjitha raportet do të publikohen në faqen e internetit të secilit institucion. Të gjithë 11 garuesit zgjedhorë dorëzuan raporte të përkohshëm për financimin e fushatës më 1 dhe 10 dhjetor, duke i deklaruar donacionet dhe shpenzimet të cilët u publikuan në faqe të internetit. Shpenzimet në nëntë raporte i tejkalonin kontributet, ku VMRO-DPMNE ka mospërputhjen më të lartë e cila shkon në më shumë se 600,000 Euro në raportin e parë dhe 1 milion Euro në të dytin.⁴⁹ Raportet e dorëzuar nga BESA dhe VMRO-PP përmbanin donacione të cilët tejkalonin limitet e lejuar.⁵⁰ Raportet përfundimtarë duhej të dorëzoheshin brenda 30 ditë pas mbylljes së llogarive bankare, që mund të shkojë edhe deri në katër muaj pas mbarimit të zgjedhjeve.⁵¹ MVZ-ja e OSBE/ODIHR nuk është informuar për ndonjë sanksionim të ndërlidhur me financimin e fushatës.

Rregulloret për financim të fushatës janë gjithëpërfshirëse dhe obligojnë raportim të shpeshtë nga ana e garuesve. Megjithatë, transparencja është zvogëluar për shkak të mungesës së kushtit për mbështetje të raportit me deklarata dhe vërtetime të bankës dhe për shkak të mungesës së raporteve të specifikuar të cilët mund të sigurojnë më shumë transparencë dhe përgjegjësi efektive.⁵² ESHA informoi MVZ-në e OSBE/ODIHR se vetëm në bazë të ankesës mund të kryen auditim, përfshirë këtu edhe kontrollin e

⁴⁹ Raporte me mospërputhje kishte nga BESA, Partia Liberale, PPD, BDI, PDSH dhe *Levica*.

⁵⁰ Kodi Zgjedhor përcakton gjobë deri 9,000 Euro me kundërvlerë në MKD për mosdorëzim të raporteve për financim të fushatës dhe pezullim ose humbje (të pjesshme ose të plotë) të kompensimit të shpenzimeve zgjedhore për tejkalimin e limitit të shpenzimeve. Megjithatë, Kodi Penal përcakton dënim me së paku pesë vite për mosdorëzimin e raportit dhe/ose tejkalimin e limitit të shpenzimeve.

⁵¹ Paragrafi 200 i [Udhëzuesit të OSBE/ODIHR dhe i Komisionit të Venecias i vitit 2010 për Rregullimin e Partive Politike](#) thotë se “Raportet për financim të fushatës duhet dorëzuar tek autoritetet përkatëse brenda një afati të caktuar kohor jo më vonë se 30 ditë pas zgjedhjeve”.

⁵² Formulari i raportit përmban vija të trasha të shpenzimeve pa zbrëthim efektiv të tyre. Për shembull, vija për Reklamim dhe Propagandë përfshinë të gjitha shpenzimet e bëra për reklamim mediatik, pllakatet, bilbordet, evenimentet e fushatës, etj. pa pasur asnjë zbrëthim të tyre. Kjo e bën të pamundshëm krahasimin, për shembull, sa filmime televizive janë deklaruar nga garuesit, kundrejt sa prej tyre janë shfrytëzuar.

kryqëzuar të harxhimeve në nivel lokal.⁵³

Mund të merret në konsideratë që ESHA-së ti jepen kompetenca ex officio për kryerje të auditimit të plotë të financimit të fushatave, përfshirë edhe kërkimin e dokumentacionit dhe informacionit plotësues nga garuesit, për të siguruar shqyrtim gjithëpërfshirës kundër ndonjë shkeljeje të mundshme.

XI. MEDIAT

A. KLIMA MEDIATIKE

Skena mediatike përfshinë mbi 130 radio kanale dhe televizione të cilët operojnë në një treg relativisht të vogël të ndarë në vija politike dhe etnike. Televizioni është burimi më i rëndësishëm i informacionit për rreth 75 për qind të popullatës.⁵⁴ Mediat transmetuese më të popullarizuara janë kanalet televizive *Sitel*, *Kanal 5* dhe *Telma*. Transmetuesi publik, Radio dhe Televizioni Maqedonas (MRT), drejton MRT1, MRT2 dhe një Kanal Parlamentar si dhe tre radiostacione.⁵⁵

Shumë bashkëbisedues të MVZ-së të OSBE/ODIHR, përfshirë dhe gazetarët, shprehën shqetësime rreth vetë-censurimit dhe mungesës së pavarësisë editoriale për shkak të interesave politikë dhe afarist. Edhe pse gjatë vitit 2016 nuk kishte fushata mediatike të financuara nga qeveria në mediat private dhe ishin të ndaluara gjatë periudhës zgjedhore, ato mbetën shqetësim për një numër të bashkëbiseduesve të MVZ-së të OSBE/ODIHR të cilët këtë e perceptojnë si mënyrë për mbështetje të mediave miqësore. Rastet e gjuhës nxitëse të përdorur nga ana e gazetarëve dhe sulmet verbale ndaj gazetarëve gjithashtu u cekën si çështje për shqetësim.⁵⁶ Gjatë fushatës, MVZ-ja e OSBE/ODIHR u njoftua për një rast të frikësimit të pretenduar të një redaktori të lajmeve nga ana e përfaqësuesve të BDI-së. Në MVZ-në e OSBE/ODIHR nga të punësuar në mediat publike u raportua për presion dhe tentim të aktorëve politikë të ndikojnë në vendimet editoriale të të punësuarve.

Duhet bërë përpjekje për forcimin e mëtejme të pavarësisë editoriale të mediave publike nga ndikimi politik me qëllim që të lehtësohet qasja e qytetarëve në informacion pluralist.

Çdo blerje e reklamave të financuara nga qeveria në mediat private duhet gjithnjë të bëhet në bazë të kriterëve objektiv dhe jo diskriminues, me transparencë të plotë dhe në kohë të harxhimeve të bëra.

B. KORNIZA LIGJORE PËR MEDIAT

Kodi Zgjedhor drejton mbulimin mediatik të zgjedhjeve. Ndryshimet e rëndësishme të vitit 2015, për herë të parë të testuar gjatë zgjedhjeve 2016, trajtuan disa çështje shqetësuese të identifikuar më parë

⁵³ Paragrafi 220 i [Udhëzuesit të OSBE/ODIHR dhe i Komisionit të Venecias i vitit 2010 për Rregullimin e Partive Politike](#) thotë se “Legjislacioni duhet të përmbajë udhëzues për mënyrën se si një shkelje ligjore mund të vihet në vëmendje të organeve rregullatorë, çfarë kompetenca hetimore u jepen organeve të tilla, si dhe sferën e sanksioneve të aplikueshme. Në përgjithësi, legjislacioni duhet të iu sigurojë rregullatorëve mundësinë, aftësinë për hetim dhe ndjekje të shkeljeve të mundshme. Pa kompetenca të tilla hetimore, ka pak gjasa që organet rregullatorë të kenë mundësinë për implementim efektiv të mandatit të tyre. Gjithashtu nevojitet financim adekuat për të siguruar funksionim dhe veprim të duhur të organit rregullator.”

⁵⁴ Sipas [analizës](#) të bërë në emër të Agjencisë për Media dhe Shërbime Audio dhe Audiovizuale (AMSAA).

⁵⁵ E financuar nga taksa për licencë e mbledhur nga qytetarët, të ardhura nga reklamimi dhe aktivitete tjera si dhe nga subvencionet qeveritare.

⁵⁶ Po ashtu, gjatë kohës së prezencës së MVZ-së të OSBE/ODIHR, një gazetar i arrestuar që nga prilli 2016 u gjykua për spiunazh, shantazh dhe bashkim kriminal, që nga shoqata vendore e gazetarëve dhe sindikata e gazetarëve u perceptua si rast politikisht i motivuar; Shih [paralajmërimin](#) e Këshillit të Evropës. Përveç kësaj, për arsye të panjohura, për katër të Premte radhazi para zgjedhjeve, nuk kishte qasje në uebfaqen kritike (SDK.mk).

përfshirë ndalimin e reklamimit të financuar nga qeveria në periudhën para-zgjedhore dhe mbulimin e zyrtarëve shtetërorë që favorizojnë partitë politike gjatë zgjedhjeve. Ndryshimet gjithashtu mundësojnë afate më të shkurta për ankesat dhe procedurat për kundërvajtje lidhur me mediat.

Nga të gjithë transmetuesit kërkohet të mundësojnë mbulim të balancuar gjatë periudhës së fushatës, në përputhje me parimin e proporcionalitetit të bazuar në numrin e listave të konfirmuara të kandidatëve. Transmetuesi publik MRT duhet tu sigurojë garuesve pjesën e paraparë të mbulimit në të gjitha edicionet e lajmeve dhe gjithashtu të sigurojë qasje në transmetim falas dhe realizim të debateve.⁵⁷

Siç u rekomandua më parë, detyrimi ligjor i MRT-së për të mundësuar kohëzgjatje ekzakte në çdo edicion lajmesh të dedikuar mbulimit të aktiviteteve të fushatës së një garuesi individual mund të zëvendësohet me një detyrim më të përgjithshëm, për të mundësuar paanshmëri dhe balancë duke respektuar pavarësinë editoriale.

Kodi Zgjedhor mundëson 18 minuta të reklamimit të paguar për çdo orë të transmetimit, përderisa media transmetuese gjithashtu mund të emetojë 12 minuta plotësuese të reklamave komerciale. Mjaft bashkëbisedues të MVZ-së të OSBE/ODIHR konsiderojnë se 30 minuta të reklamave në një orë janë të tepërta. Mediat private të cilët ofruan reklamim të paguar politik duhej tu siguronin partive parlamentare mundësinë për të blerë në raporte të drejta kohë të tillë të transmetimit. Disa nga partitë jo-parlamentare u ankuan për sasinë e vogël të kohës së paguar të vënë në dispozicion të tyre në mënyrë jo proporcionale.⁵⁸

Dispozitat që përcaktojnë shpërndarjen e reklamimit të paguar mund të rishikohen me qëllim që të mundësohet qasje më e madhe për partitë jo-parlamentare.

Reformat substanciale në media të parapara me Marrëveshjen e Përzahinos nuk u finalizuan dhe nuk u zbatuan para zgjedhjeve. Në korrik 2016, katër partitë më të mëdha parlamentare ranë dakord të zbatojnë masa të veçanta të përkohshme për këto zgjedhje. Këto përfshinin emërimin e kryeredaktorit të MRT1 nga opozita (në konsultim me partitë tjera parlamentare) 100 ditë para zgjedhjeve, mandati i të cilit përfundon natën e zgjedhjeve, dhe formimin e Komisionit të Përkohshëm për monitorim të mbulimit mediatik gjatë periudhës parazgjedhore.

Komisioni i Përkohshëm, organ pesë anëtarësh, përbëhej nga katër anëtarë të propozuar nga partitë politike (dy nga partitë në pushtet dhe dy nga opozita) dhe anëtari i pestë i zgjedhur nga katër anëtarët e propozuar partiak. Komisioni morri rolin mbikëqyrës të Agjencisë për Media dhe Shërbime Audio dhe Audiovizuale (AMSAA), organ rregullator për transmetim mediatik. Komisioni i Përkohshëm kishte mandat të mbikëqyrë mediat për një periudhë më të gjatë se tre muaj para zgjedhjeve. Megjithatë, amendamente të caktuar të Kodit Zgjedhor nuk u harmonizuan plotësisht brenda Kodit, duke shkaktuar paqartësi për mandatin e Komisionit për periudhën prej 17 tetor, kur u shpallën zgjedhjet, deri më 21 nëntor, kur zyrtarisht filloi fushata.⁵⁹

Siç u rekomandua më parë, Kodi Zgjedhor mund të ndryshohet për të qartësuar detyrimet për raportim të balancuar gjatë periudhës parazgjedhore. Mund të merret në konsideratë përforcimi i mëtejme i

⁵⁷ Neni 76a(2) i Kodit Zgjedhor përcakton se mbulimi në çdo edicion të lajmeve nga transmetuesi publik duhet të ndahet në 30 për qind për ngjarje vendore dhe ndërkombëtare, 30 për qind për aktivitetet e fushatës së shumicës parlamentare, 30 për qind të opozitës parlamentare dhe 10 për qind të partive jashtë-parlamentare.

⁵⁸ Partitë e pa përfaqësuara në parlament mund të blejnë vetëm një minutë për reklamim për çdo orë, në krahasim me 17 minuta nga koha e mundësuar për partitë parlamentare, e shpërndarë në maksimum 8 minuta në orë për partitë në pushtet, 8 minuta për partitë më të mëdha opozitare të përfaqësuara në parlament dhe 1 minutë për partitë e vogla parlamentare.

⁵⁹ Neni 75a obligon transmetuesit të sigurojnë mbulim të balancuar të zgjedhjeve në të gjitha format e përfaqësimit zgjedhor në media sipas parimit të proporcionalitetit në bazë të listave të konfirmuara të kandidatëve.

pavarësisht së AMSAA-së duke i dhënë resurse më të mëdha për sigurimin e rolit mbikëqyrës të tij dhe duke i siguruar kompetenca sanksionuese efektive, proporcionale dhe ndaluese.

Komisioni vlerësoi mbulimin mediatik të aktorëve politik dhe garuesve nga transmetuesit në bazë të raporteve monitoruese të përgatitur nga AMSAA çdo 10 ditë.⁶⁰ Vendimet e Komisionit u bazuan në interpretimin e anëtarëve të tij të rezultateve të monitorimit të mediave nga AMSAA. Vendimet kishin mospërputhje dhe nganjëherë nuk pasqyronin seriozitetin e shkeljeve të pretenduara.⁶¹ Komisioni propozoi mbi 60 procedime për kundërvajtje.⁶² 16 prej tyre ishin për mbulim të pa balancuar,⁶³ 6 për fushatë të fshehtë nga zyrtarë qeveritarë,⁶⁴ dhe 29 në lidhje me reklamim politik.⁶⁵ Gjithashtu kishte 13 raste që kishin të bënin me thyerjen e heshtjes parazgjedhore. Në përgjithësi nuk u respektuan afatet për sjellje të vendimit për ankesat lidhur me mediat.⁶⁶ Para ditës së zgjedhjeve gjykatat shqyrtuan vetëm dy raste, duke i refuzuar të dyja.



C. REZULTATET E MONITORIMIT TË MEDIAVE

Garuesit në zgjedhje kishin qasje në media për bërje të fushatës, përfshirë edhe kohë të transmetimit falas në mediat publike. Mediat transmetuese mundësuan mbulim të fushatave të garuesve në edicionet e rregullta të lajmeve. Edhe pse mediat publike dhe disa private bënë përpjekje të organizojnë debate me të gjithë garuesit, këto përpjekje rezultuan të pasuksesshme për shkak të refuzimit të kandidatëve për të marrë pjesë.

MVZ-ja e OSBE/ODIHR bëri monitorim të mediave në tetë kanale televizive dhe pesë gazeta ditore.⁶⁷ Rezultatet e monitorimit treguan se dy kanalet televizive publike në përgjithësi iu bindën rregullore për mbulimin e garuesve gjatë fushatës. Në programet e lajmeve të MRT1 koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE dhe BDI në kombinim morën 40 për qind të mbulimit, ndërsa për partitë opozitare u ndanë 43 për qind dhe 11 për qind për partitë jashtë-parlamentare. MRT1 portretizoi garuesit në mënyrë pozitive dhe jo kritike. Gjatë heshtjes parazgjedhore, MRT1 shfaqti një dokumentar për figurën historike kontroverze të cilin gjatë një tubimi para fillimit të fushatës e përmendi lideri i VMRO-DPMNE-së.⁶⁸

Në shërbimin e MRT2, kryesisht në gjuhën shqipe, shpërndarja e mbulimit mes koalicionit qeveritar parlamentar dhe partive opozitare ishte ngjashëm i drejtë me 42 dhe 39 për qind. Partitë jashtë

⁶⁰ Ndonëse e paraparë me ligj, AMSAA nuk mbikëqyri mbulimin zgjedhor në portalet mediatike për shkak të rregulloreve të paqarta që përcaktojnë se “Kodi Zgjedhor nuk përkufizon termin ‘Portal interneti’ apo sferën e portalit, dhe ...një përkufizim i këtij termi nuk mund të gjendet në ligjet tjera vendore”.

⁶¹ Për shembull, në seancën për vlerësim të periudhës së dytë 10-ditore të fushatës, Komisioni vendosi të mos iniciojë akuzë kundër asnjë prej mediave, pavarësisht animit të dukshëm dhe mosrespektimit të ligjit nga disa, siç është dokumentuar në raportet e monitorimit mediatik të AMSAA. Për kundër kësaj, në vlerësimin e periudhës së parë 10-ditore të fushatës, Komisioni propozoi ngritjen e akuzave kundër disa mediave pavarësisht se raportet monitoruese në disa raste nuk siguronin bazë të fortë për rekomandime të tilla.

⁶² As AMSAA as Komisioni i Përkohshëm nuk kanë fuqi ligjore për të vendosë sanksione në mënyrë direkte, por AMSAA mund të sjellë shkeljet e identifikuara në vëmendje të gjykatave.

⁶³ *Sitel* dhe *TV Nova* (nga 5 raste secili) dhe *Alfa*, *TV Telma*, *24 Vesti*, *Alsar-M*, *Kanal 5* dhe *TV Shenja* (nga 1 rast secili).

⁶⁴ *Sitel*, *Alfa* dhe *TV Nova* (nga 2 raste secili).

⁶⁵ Kjo përfshinte gjatësinë e segmenteve reklamuese për një parti ose bllok të caktuar, që ishte më i gjatë se sa parasheh ligji, ose reklama të cilat transmetoheshin jashtë periudhës së fushatës.

⁶⁶ Gjykata duhet të vendosë për një kërkesë për kundërvajtje brenda 48 orëve. Vendimi i gjykatës mund të apelohe brenda 24 orëve. Gjykata e shkallës së dytë duhet të vendosë për apelimin brenda 48 orëve.

⁶⁷ Monitorimi i mediave nga MVZ i OSBE/ODIHR i realizuar nga 7 nëntori përfshinë programet qendrore të transmetuar nga kanalet publike MRT1 dhe MRT2 dhe kanalet private *Sitel*, *Kanal 5*, *Alfa*, *Telma* dhe *Alsar-M* (mes orës 18:00 dhe 24:00) dhe edicionet e lajmeve kryesore të *24 Vesti* (në ora 20:00), si dhe gazetatat ditore *Dnevnik*, *Koha*, *Lajm*, *Sloboden Peçat* dhe *Vest*.

⁶⁸ Më 10 dhjetor, MRT1 transmetoi film dokumentar për Andon Qoseto, të cilin e përmend lideri i VMRO-DPMNE-së në fjalimin e tij të fushatës më 6 dhjetor.

parlamentit morën 14 për qind të mbulimit. Megjithatë edicionet e lajmeve dedikuan pjesë më të madhe të mbulimit për partitë shqiptare. Aktorët politikë u prezantuan kryesisht në mënyrë pozitive ose neutrale.

Kanali privat *Sitel*, *Kanal 5* dhe *Alfa* nuk siguruan mbulim të balancuar dhe të paanshëm në lajmet e tyre, siç u demonstrua në aspektin kuantitativ dhe kualitativ të mbulimit mediatik. Tre kanalet u fokusuan në dy koalicionet e mëdha të udhëhequra nga VMRO-DPMNE dhe LSDM, të cilët në mënyrë të kombinuar fituan prej 88 për qind në *Alfa* deri në 93 për qind në *Kanal 5*. Përderisa koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE dhe nga LSDM morën pjesë të barabarta të mbulimit, koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE u prezantua kryesisht pozitivisht, ndërsa i dyti shpesh prezantohet në dritë negative, posaçërisht në *Sitel*. Që të tre kanalet televizive u fokusuan në mesazhet e fushatës së koalicionit të udhëhequr nga VMRO-DPMNE. Informacione të pasigurt që vinin nga interneti prezantoheshin kohë pas kohe si lajme politike.

Alsat-M, *Telma* dhe *24 Vesti* në lajmet e tyre në përgjithësi ofruan mbulim të shumëllojshëm dhe shpesh kritik për garuesit dhe aktorët politikë. Ndërsa *Telma* dhe *24 Vesti* u koncentruan më shumë në dy koalicionet e mëdha,⁶⁹ por gjithashtu edhe koalicionet dhe partitë tjera morën pjesë domethënëse të mbulimit në lajme.⁷⁰ Të tre kanalet iu dhanë mundësi garuesve të prezantojnë platformat e tyre gjatë debateve ose intervistave.

Gazetat ditore të monitoruara në përgjithësi dhanë vështrime të ndryshme dhe duke anuar ndaj disa parti të caktuara. *Dnevnik* favorizoi koalicionin e udhëhequr nga VMRO-DPMNE, që fitoi pjesën më të madhe të mbulimit dhe ishte kritik ndaj koalicionit të udhëhequr nga LSDM-ja. *Vest* po ashtu qartazi favorizoi koalicionin e udhëhequr nga VMRO-DPMNE. *Sloboden Peçat* favorizoi koalicionin e udhëhequr nga LSDM-ja, dhe ishte shumë kritik ndaj partive në pushtet. *Koha* dhe *Lajm* qartazi u fokusuan në partitë etnike shqiptare. Përderisa *Koha* anonte nga BDI-ja dhe prezantoi në përgjithësi mbulim pozitiv të garuesve, *Lajm* ishte shumë kritik ndaj partive në pushtet, posaçërisht ndaj BDI-së, e cila edhe mori pjesën më të madhe të mbulimit.

XII. VËZHguesIT VENDORË DHE NDËRKOMBËTARË

Kodi Zgjedhor parasheh vëzhgimin vendor, partiak dhe ndërkombëtar. Gjithsej 642 vëzhgues ndërkombëtarë, 98 gazetarë ndërkombëtarë dhe 7,605 vëzhgues vendorë u akredituan për këto zgjedhje. Organizatat kryesore vëzhguese qytetare MOST dhe CIVIL ndërmorën aktivitete vëzhguese afatgjatë dhe afatshkurtër. MOST angazhoi 80 VAGJ dhe rreth 3,300 VASH, dhe CIVIL angazhoi 35 VAGJ dhe rreth 300 VASH. MOST po ashtu realizoi nxjerrje paralele të votave.⁷¹ Pjesëmarrja aktive e vëzhguesve civil në të gjitha fazat e procesit zgjedhor mundësoi arritjen e një niveli të rëndësishëm të transparencës.

Pak para ditës së zgjedhjeve, 19 organizata të shoqërisë civile (pjesë e fushatës për ndërgjegjësimin e votuesve të udhëhequr nga Fondacioni Shoqëri e Hapur – Maqedoni), u njoftuan për vendosjen e auditimit financiar.⁷² Këto organizata shprehën dyshime lidhur me kohën e vendosjes së këtij hetimi,

⁶⁹ Në *Telma*, koalicioni i udhëhequr nga VMRO-DPMNE mori 27 për qind të mbulimit në krahasim me 23 për qind të ndarë për koalicionin e udhëhequr nga LSDM; në *24 Vesti* mbulimi ishte 30 për qind krahasuar me 19 për qind.

⁷⁰ *Alsat-M* ndau 25 për qind të mbulimit në lajme për koalicionin e udhëhequr nga VMRO-DPMNE ndërsa BDI mori 21 për qind dhe koalicioni i udhëhequr nga LSDM mori 15 për qind të mbulimit; ngjashëm në *Telma* dhe në *24 Vesti*, pjesë e konsiderueshme e mbulimit iu nda partive dhe koalicioneve të tjera.

⁷¹ Nxjerrjet paralele të rezultateve të votimit [u shpallën më 12 dhjetor](#) dhe në përgjithësi u përputhën me rezultatet e zgjedhjeve në nivel të njësisë zgjedhore.

⁷² Auditimet financiare u iniciuan për Shoqatën e Punëtorëve të Tekstilit dhe Ngjyrosjes *Glasno* - Shtip (më 7 dhjetor), Shoqatën për Zhvillim Lokal ACTION PLUS - Resnjë (më 9 dhjetor), Shoqatën për Zhvillim dhe Aktivizëm AQUA - Strugë (12 dhjetor) dhe Fondacionin Shoqëri e Hapur – Maqedoni (14 dhjetor).

dhe u detyruan të veprojnë në kushte jo të favorshme për pjesëmarrje të shoqërisë civile në çështjet publike.⁷³

XIII. ANKESAT DHE APELIMET

KSHZ-ja u mor me shumicën e kontesteve administrative që kanë të bëjnë me zgjedhjet. ESHA dhe KSHPK u morën me ankesat në lidhje me financimin e fushatës dhe keqpërdorimin e resurseve administrative. Ndryshimet në Kodin Zgjedhor të vitit 2015 përforcuan garancitë ligjore për zgjidhjen e kontesteve zgjedhore. Në pajtim me rekomandimet e mëhershme të OSBE/ODIHR dhe Komisionit të Venecias, ndryshimet përfshinin afate më të shkurtër, shpalljen e vendimeve administrative brenda 24 orëve, dhe garantimin e të drejtës për apelim të të gjitha vendimeve administrative në Gjykatën Administrative. Përveç kësaj, në bazë të rekomandimeve të mëparshme, KSHZ-ja miratoi rregulloren për procedurë për trajtimin e ankesave. Megjithatë, përkundër obligimit ligjor, KSHZ-ja nuk implementoi një sistem elektronik për menaxhimin e rasteve dhe ankesave. Po ashtu, KKZ-të nuk kishin kompetencë për shqyrtimin e ankesave për çështjet që ishin në përgjegjësinë e tyre administrative. Kjo ndikoi negativisht në koordinimin kohor në procesin e ankesave dhe apeliemeve meqë ato shpeshherë shqyrtoheshin nga KSHZ-ja në mënyrë të centralizuar dhe me vonesë.

KSHZ pranoi 11 ankesa para ditës së zgjedhjeve, shumica e të cilave u hodhën poshtë për shkak të mungesës së juridiksionit ose fakteve.⁷⁴ Dy vendime të KSHZ-së në lidhje me refuzimin e listave të kandidatëve të Partisë Social Demokratë të Maqedonisë dhe Lëvizjes Popullore të Maqedonisë u apeluar në Gjykatën Administrative dhe të dyja, në një seancë të mbyllur, u refuzuan si të pabazuara.⁷⁵ Edhe pse vendimet ishin publikuar në uebfaqen e gjykatës, mungesa e seancës të garantuar dëgjimore nga Gjykata Administrative mund të ndikojë në uljen e besimit publik ndaj procesit dhe është në kundërshtim me angazhimet e OSBE-së dhe obligimet dhe standardet tjera ndërkombëtare.⁷⁶ Në përgjithësi, pavarësisht përmirësimeve të Kodit Zgjedhor, zbatimi i procedurave për zgjidhjen e kontesteve zgjedhore nuk mundësoi plotësisht kompensim efektiv juridik siç parashikohet në angazhimet e OSBE-së dhe standardet e Këshillit të Evropës.⁷⁷ Po ashtu, shumë bashkëbisedues të MVZ të OSBE/ODIHR ngritën shqetësimet e tyre lidhur me pavarësinë gjyqësore.⁷⁸

Siç u rekomandua më parë, Kodi Zgjedhor duhet të harmonizohet me Kushtetutën dhe qartësisht të përcaktojë se të gjitha seancat dëgjimore gjyqësore për rastet që kanë të bëjnë me zgjedhjet duhet të jenë të hapura për publikun dhe vendimet duhet të publikohen menjëherë.

⁷³ Neni 13 i Konventës të Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit parashikon që “Secili shtet pjesëmarrës merr masa përkatëse, brenda mundësive të tij dhe në pajtim me parimet themelore të ligjit vendor, për të nxitur pjesëmarrjen aktive të individëve dhe grupeve jashtë sektorit publik, siç është shoqëria civile, organizatat joqeveritare dhe organizatat e bazuara mbi komunitet ...”.

⁷⁴ Shumica e ankesave ishin pretendime për fushatë të parakohshme; shkelje të Nenit 8-a të Kodit Zgjedhor ose ndërprerje të punësimit në institucionet shtetërore dhe publike; mbajtje anë nga ana e kryetarëve dhe anëtarëve të KKZ-ve; dhe ndryshim lokacioni të vendvotimit.

⁷⁵ Sipas Kushtetutës, seancat dëgjimore gjyqësore dhe marrja e vendimit është publik. Publiku mund të përjashtohet vetëm në rastet e caktuara me ligj. Ligji për Gjykata përcakton se procedimet para gjykatës duhet të bazohen në parimin e publicitetit dhe transparencës.

⁷⁶ Paragrafi 12 i [Dokumentit të Kopenhagës i OSBE-së i vitit 1990](#) përcakton se “procedimet mund të mbahen të mbyllura vetëm në rrethanat e përcaktuara me ligj dhe në pajtim me obligimet që dalin nga ligjet dhe zotimet ndërkombëtare”. Shiko gjithashtu Nenin 10 të [Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut](#) dhe Nenin 14 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejta Civile dhe Politike (ICCPR).

⁷⁷ Paragrafi 5.10 i [Dokumentit të Kopenhagës i OSBE-së i vitit 1990](#) konstaton se “secili do të fitojë masa efektive për kompensim kundër vendimeve administrative me të cilën do të garantohet respektimi i të drejtave themelore dhe sigurimi i integritetit ligjor”. Shiko po ashtu pjesën 3.3 të [Kodit për Praktikë të Mirë të Komisionit të Venecias i vitit 2002](#).

⁷⁸ Shiko [Vërejtjet Përfundimtare nga Raporti i Tretë Periodik për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë](#) të Komisionit të KB për të Drejtat e Njeriut.

Mund të merret në konsideratë decentralizimi i mekanizmit për zgjidhje të kontesteve zgjedhore. KKZ-të mund të obligohen me detyrë për trajtimin e ankesave për çështjet të cilat bien në përgjegjësitë e tyre administrative që të mundësohet kompensim efektiv dhe në kohë.

KSHPK pranoi rreth 10 ankesa, shumica të dorëzuara nga LSDM-ja kundër zyrtarëve të VMRO-DPMNE-së në lidhje me keqpërdorimin e resurseve shtetërore.⁷⁹ Seancat dëgjimore të këtyre rasteve ishin të hapura dhe KSHPK kërkoi nga Prokuroria Themelore Publike të iniciojë një numër të hetimeve. Po ashtu, Avokati i Popullit inicioi 10 hetime lidhur me pretendime për presione ndaj punonjësve publik dhe gabimeve në listat votuese.

Dy iniciativa tjera ishin dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese ku sfidohet kushtetutshmëria e dispozitave lidhur me zgjedhjet. Më 9 nëntor, Gjykata Kushtetuese i refuzoi të dyja: një nga BESA, që sfidonte dispozitën me të cilën kërkohet nga votuesit me të dhëna të “diskutueshme” të ri-regjistrohen (pa juridiksion) dhe një nga Lëvizja Popullore e Maqedonisë që sfidonte përbërjen e Komisionit të Përkohshëm për Media (i pabazuar).

XIV. PJESËMARRJA E PAKICAVE KOMBËTARE

Partitë dhe koalicionet që kryesisht përfaqësojnë komunitetin etnik shqiptar garuan të pavarur, ndërsa partitë dhe kandidatët që përfaqësonin komunitetet më të vogla etnike iu bashkëngjitën koalicioneve të udhëhequra nga partitë që përfaqësonin komunitetet më të mëdha.⁸⁰ Të dy koalicionet e udhëhequra nga LSDM dhe VMRO-DPMNE në listat e tyre përfshinin përfaqësues të pothuajse të gjitha komuniteteve dhe shtatë prej tyre hynë në parlament.⁸¹ Sikur që ishte rast edhe në të kaluarën, shumica e partive përfaqësuese të komuniteteve më të vogla garuan në koalicionin e VMRO-DPMNE-së.

Për herë të parë Koalicioni i udhëhequr nga LSDM-ja në mënyrë aktive kërkoi votat e komuniteti etnik shqiptar, përfshirë edhe vendosjen e kandidatëve etnik shqiptarë në vende fituese në listë. Disa parti etnike shqiptare e kontestuan të drejtën e një partie etnike maqedonase për tërheqje të votave shqiptare.⁸²

Temat lidhur me raportet ndëretnike u shfaqën dukshëm gjatë fushatës, përfshi raportet institucionale mes komuniteteve etnike shqiptare dhe maqedonase dhe përdorimi zyrtar i gjuhëve. Gara zgjedhore ishte veçanërisht konkurruese tek komuniteti etnik shqiptar ku forcat e formuara të reja politike siç janë Aleanca për Shqiptarët dhe BESA, si edhe LSDM, sfiduan pozitën dominuese të BDI-së dhe PDSH-së.

Mbulimi mediatik i komuniteteve më të vogla dhe pjesëmarrja e tyre në zgjedhje, përfshi tubimet dhe deklaratat e partive, ishte i limituar. Raportimi mbi aktivitetet politike të komuniteteve më të vogla,

⁷⁹ Një ankesë është dorëzuar nga Zëvendës Ministri Plotësues i Brendshëm që pretendonte keqpërdorim të pozitës zyrtare të Ministrit i cili punonjësve iu ndryshoi vendet e punës dhe ngriti pagat e tyre. E dyta, e dorëzuar nga VMRO-DPMNE pretendonte përdorimin e veturave zyrtare për transportim të materialeve për fushatë të LSDM-së. LSDM dorëzoi ankesa tjera që pretendonin aktivitete të fushatës nga VMRO-DPMNE në azil të pleqve; për praninë e zyrtarëve të VMRO-DPMNE-së gjatë hedhjes së gurë themelit të një sistemi për furnizim me ujë në Makedonska Kamenica dhe gjatë fillimit të ndërtimit të një çerdheje për fëmijë në Zërnovce dhe përdorim të veturave qeveritare për transportim të materialit për fushatë të VMRO-DPMNE-së në Shtip.

⁸⁰ Shumica e partive përfaqësuese të komuniteteve etnike joshqiptare thirrën për shkrirje të shtatë njësisve zgjedhore në një të vetme për tërë vendin dhe për formimin e vendeve të garantuara në parlament, për të iu mundësuar atyre të garojnë në mënyrë të pavarur.

⁸¹ Nga dy deputetë kanë deklaruar përkatësinë e tyre të komunitetit Boshnjak, Rom dhe Turk, dhe një me përkatësi etnike Serbe.

⁸² Gjithsej, 22 deputet të zgjedhur janë etnik shqiptarë: 20 të zgjedhur brenda partive dhe koalicioneve etnike shqiptare dhe dy me LSDM.

veçanërisht të Romëve, shpesh përmbante stereotipe negative. Edhe pse materialet zgjedhore u siguruan në gjuhët e pakicave kombëtare, nuk kishte asnjë fushatë të posaçme për edukimin e votuesve për komunitetet më të vogla ose në gjuhën e tyre.

Përveç komunitetit etnik shqiptar, edhe komunitetet më të vogla duke përfshirë komunitetin Romë, deklaruan se pastrimi i Listës së votuesve i kishte prekur në mënyrë joproporcionale, ndoshta për shkak se këto komunitete nuk u informuan në mënyrë adekuate për nevojën për ri-regjistrim aktiv.

Mediat duhet të ndajnë më shumë hapësirë për komunitetet më të vogla dhe përfaqësuesit e tyre. Fushatat për ndërgjegjësim dhe edukim të votuesve, përfshirë edhe të drejtën e votuesit për të hedhë votën pa frikë nga hakmarrja, duhet të kenë në shënjestër komunitetet më të vogla dhe mundësisht të jenë në gjuhën e komunitetit.

XV. VOTIMI I PARAKOHSHËM DHE DITA E ZGJEDHJEVE

Votimi i parakohshëm në përgjithësi u krye në rregull pa incidente ose tensione të mëdha. Transparenca ishte përforcuar me praninë e vëzhguesve civilë dhe partiak gjatë tërë ditës në vendvotimet e vëzhguara.

A. VOTIMI I PARAKOHSHËM DHE ME POSTË

Votimi i parakohshëm u mbajt në 7 dhjetor për anëtarët e KZ-ve për jashtë vendit dhe në 10 dhjetor për votuesit me postë, personat e shpërngulur brenda vendit, të paraburgosurit dhe të burgosurit. Për votim të parakohshëm ishin regjistruar gjithsej 8,099 persona (afër 0.5 për qind të votuesve të regjistruar), përfshirë 5,746 votues me postë. Votuesit e sëmurë dhe ata me aftësi të kufizuara u deshtë të parashtronjë kërkesë tek KKZ-ja përkatëse shtatë ditë para ditës së zgjedhjeve. Me qëllim të zvogëlimit të shpërdorimit të mundshëm të votimit me postë, KSHZ-ja miratoi një udhëzues që përkufizonte kategorinë e votuesve të mundshëm me postë, dokumentet përcjellëse të aplikacionit dhe kush mund të dorëzojë kërkesën për votim në emër të votuesit me postë. Mirëpo kjo ngeli e paqartë dhe një numër i KKZ-ve kërkuan qartësime se sa herë një person i njëjtë mund të shërbejë si i afërt i një personi për votim me postë.

Votimi i parakohshëm vlerësohet pozitivisht në tërësi, përveç tre vërejtjeve. U vërejtën probleme procedurale në lidhje me kutitë e votave jo të vulosura si duhet në shtatë raste, dhe fshehtësia e votës jo gjithmonë e siguruar në tetë raste. Gjatë votimit në burgun e Idrizovës MVZ-ja e OSBE/ODIHR vërejtë disa të burgosur me letërnjoftime të vlefshme që nuk mundën të votojnë sepse nuk u gjetën në Listën e votuesve.⁸³ Mbi 500 të burgosur nuk ishin përfshirë në Listë për shkak të dokumenteve të skaduar.

Për të iu shmangur heqjes të së drejtës për votim në burg, duhet korrigjuar mangësitë ligjore që kanë të bëjnë me përtëritjen e dokumenteve të tyre të identifikimit.

⁸³ Rreth 50 për qind të të burgosurve në burgun e Idrizovës, 30 për qind të atyre në burgun e Shuto Orizarës, si dhe në burgjet në Shtip e Veles, nuk mundën të votojnë meqë nuk ishin në Listën e votuesve. Paragrafi 22 i [Vërejtjet Përfundimtare nga Raporti i Tretë Periodik për ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë](#) të Komisionit të KB për të Drejtat e Njeriut përcakton se “Shteti pjesëmarrës duhet të sigurojë që e drejta për votim të iu mundësohet të gjithë qytetarëve, përfshirë personat me aftësi të kufizuara dhe personat e privuar nga liria. Shteti pjesëmarrës duhet gjithashtu të merr masa për korrigjimin e të gjitha pengesave administrative për të siguruar të drejta të plota dhe të barabarta për votim për të gjithë qytetarët”.

B. VOTIMI

Në ditën e zgjedhjeve, pothuajse të gjitha vendvotimet e vëzhguar u hapën në kohë. Procesi i hapjes u vlerësua pozitivisht në shumicën e fushave, megjithatë vëzhguesit vërejtën disa probleme procedurale: në 20 raste protokollit i nevojshëm nuk u plotësua para fillimit të votimit, në 21 raste kutitë e votave nuk u demonstruan se ishin të zbrazëta, dhe në 10 raste nuk u regjistrua numri i vulave për mbylljen e kutive të votave.

Procesi i votimit u vlerësua pozitivisht në 97 për qind të vëzhgimeve. Në përgjithësi, procedurat u respektuan, përfshirë edhe ato për mbrojtjen nga votimi i shumëfishtë dhe ngjyrosja e gishtave me bojë dhe kontrollimi i fotografisë në listën e votuesve. Planimetria e katër për qind të vendvotimeve të vëzhguara u vlerësua si joadekuate. Në gjysmën e këtyre rasteve, kjo ndikoi në fshehtësinë e votës. Mbipopullimi është vërejtur në pesë për qind të vendvotimeve të vizituara. Më shumë se gjysma e vendvotimeve të vëzhguara nuk lejonin qasje të pavarur për votuesit me aftësi të kufizuara fizike.⁸⁴

Duhet të ndërmerren masa për sigurimin e qasjes në të gjitha vendvotimet për personat me aftësi të kufizuara.

Në mënyrë të shprehur, në 16 për qind të vendvotimeve të vëzhguara, nuk u lejua votimi i personave për shkak se nuk gjendeshin në Listën e votuesve. Përderisa disa prej këtyre personave ishin udhëzuar për në vendvotime tjera, të tjerët deklaruan se bënë pjesë në mesin e 28,341 të dhënave të fshira në korrik 2016. Sipas KSHZ-së, 470 persona të prekur kanë deponuar ankesat e tyre për këtë çështje.⁸⁵ Kjo thekson nevojën e vazhdueshme për trajtim të qëndrueshëm të gabimeve strukturore në Listën e votuesve.

Disa parregullsi serioze u vërejtën gjatë votimit siç është votimi grupor (4 për qind të vrojttimeve), votimi në emër të tjetrit (2 për qind), dhe kuti të votave të pavulosura në mënyrë të duhur (2 për qind). Janë vërejtur incidente lidhur me presion të ushtruar ndaj votuesit dhe persona të paautorizuar duke udhëhequr punën e KZ-së. Gjatë ditës së zgjedhjeve një numër i raporteve policore dhe të medias informuan për parregullsi lidhur me blerjen e votës dhe fotografimin e fletëvotimit. MVZ-ja e OSBE/ODIHR u njoftua se së paku gjashtë persona ishin arrestuar.

Incidentet dhe parregullsitë, përfshirë fushatën dhe frikësimin e votuesve në afërsi të vendvotimeve, transportimi i organizuar i votuesve, asistimi i votuesit dhe votimi familjar u raportuan më së shpeshti nga zonat ku jetojnë shqiptarët dhe komunitetet më të vogla etnike.⁸⁶

C. NUMËRIMI I VOTAVE DHE NXJERRJA E REZULTATEVE

Procesi i numërimit të votave u vlerësua si efikas dhe transparent, i mirë ose shumë i mirë në 114 prej 127 vëzhgimeve. Megjithatë, lëshime të dukshme procedurale u vërejtën tek një numër i vendvotimeve dhe numërimi u vlerësua negativisht në 13 vendvotime të vëzhguara. Pikë së pari në lidhje me hapat e ndërmarrë para hapjes së kutive të votimit, përfshirë numërimin e nënshkrimeve dhe të fletëvotimeve të pashfrytëzuara, (28 gjegjësisht 25 raste), dhe verifikimi i numrit të vulave siguroese në kutitë e votimit (14 raste). Pas numërimit, 16 KZ u vërejtën të kishin vështirësi me plotësimin e protokolleve me rezultate, dhe 14 KZ nuk i respektuan procedurat e paketimit të materialeve të ndjeshëm zgjedhorë dhe fletëvotimet. Kopje të protokolleve iu shpërndanë atyre që kërkuan nga një; mirëpo 33 KZ të vëzhguara

⁸⁴ Shih Nenin 9 dhe 29 të [Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara \(CRPD\) e vitit 2006](#).

⁸⁵ KSHZ shqyrtoi vetëm 355 ankesa deri në përfundim të votimit (siç parashihet me ligj), dhe të gjitha i refuzoi.

⁸⁶ Raste të tilla u vërejtën dhe u raportuan për shembull në Çair, Shuto Orizarë, Koçani, si dhe në zonat rurale të Tetovës dhe Gostivarit.

nuk i postuan publikisht protokollet sipas detyrimit ligjor. Numërimi përfundoi në afatin e parashikuar ligjor në të gjitha vendvotimet e monitoruara.

Nxjerrja e rezultateve vazhdoi në kohë por u vlerësua negativisht në 8 vëzhgime. Problemet e vërejtur kryesorë kishin të bënin me kushtet në KKZ-të: hapësirë e pamjaftueshme (24 KKZ), mbipopullim (22 KKZ), dhe organizim i dobët (9 KKZ). Gjatë vëzhgimit, 336 protokolle të numërimit kishin mospërputhshmëri dhe fletëvotimet nga 40 vendvotime u ri-numëruan.

D. SHPALLJA E REZULTATEVE PARAPRAKE

Edhe pse nuk obligohet me ligj, rezultatet paraprake nga vendvotimet dhe njësitë zgjedhore u publikuan në faqen e internetit të KSHZ-së gjatë tërë natës gjë që kontribuoi në transparencën e procesit. KSHZ-ja duhej të shpallte dhe të publikonte rezultatet paraprake në ora 07:00 më 12 dhjetor mirëpo këtë e bëri vetëm në ora 21:30 kur të gjithë protokollet e KKZ-ve u pranuan dhe u konfirmuan nga ana e KSHZ-së. Sipas KSHZ-së, dalja e votuesve ishte 67 për qind. Fletëvotime të pavlefshme ishin 3.18 për qind, një numër i madh që duket se është për shkak të ngatërrimit mes çka është fletëvotim i pavlefshëm e çka i vlefshëm, si dhe moslejimit të fletëvotimeve të prishura në rast se votuesi gabon gjatë shënimit të fletëvotimit.

XVI. ZHVILLIMET PAS DITËS SË ZGJEDHJEVE DHE ANKESAT

Periodha post-zgjedhore u shënua me atmosferë të tensionuar dhe retorikë të ashpër kryesisht të VMRO-DPMNE-së.⁸⁷ Pasi që BESA dhe LSDM deponuan ankesat kundër rezultateve në disa vendvotime, VMRO-DPMNE thirri protesta para KSHZ-së. Më 17 dhjetor, lideri i VMRO-DPMNE-së prezantoi para turmës njoftimin e partisë duke akuzuar KSHZ-në dhe një numër të ambasadorëve rezidentë për ndërhyrje zgjedhore.⁸⁸ Ditën në vijim, u publikuan lajmërimi vdekjesh të përfaqësuesve të komunitetit diplomatik ndërkombëtar aktual dhe të mëparshëm në Shkup. MVZ-ja e OSBE/ODIHR nuk ka njohuri për ndonjë masë ligjore të ndërmarrë kundër këtyre veprimeve.⁸⁹

A. ANKESAT NË KSHZ PAS DITËS SË ZGJEDHJEVE

Më 13 dhjetor, BESA dhe LSDM deponuan 16 ankesa në KSHZ kundër rezultateve në disa vendvotime.⁹⁰ Këto ankesa potencialisht do të mund të ndryshonin rezultatet zgjedhore dhe formimin e koalicionit qeverisës.

⁸⁷ Protestuesit thirrën në linç të disa deputetëve të ri nga opozita, djegie të ambasadës të SHBA dhe brohorisnin "shqiptarët e mallkuar". Zyrtarë të lartë qeveritarë thirreshin në "Natën e Thikave të Gjata", dhe shprehën dëshirat për sulm kardiak dhe funeral për liderin e opozitës.

⁸⁸ U shprehën akuzat dhe deklaratat në vijim: KSHZ-ja po bën sajim post-zgjedhor; KSHZ-ja dhe Gjykata Administrative janë në presion të përfaqësuesve të huaj në vend dhe ambasadorët rezident po ndërhyjnë në politikën e vendit; Nuk do të lejohet që "kriminelin i amnistuar" Zoran Zaev të formojë qeveri; VMRO-DPMNE nuk do të merr pjesë në rivotim ose në çfarëdo negociata të ndërmjetësuar nga përfaqësuesit ndërkombëtarë, ajo nuk do të lejojë asnjë kantonizim ose ridefinim të shtetit, ajo do të luftojë për "deSOROSOizim" të shoqërisë civile dhe do të rishikojë rregulloret për financim të organizatave të shoqërisë civile.

⁸⁹ Neni 20 i [ICCPR](#) përcakton se "Çfarëdo përkrahje të urrejtjes nacionale, racore apo fetare që përbën nxitje për diskriminim, armiqësi apo dhunë duhet të ndalohet me ligj dhe ligji duhet të zbatohet".

⁹⁰ Sipas Kodit Zgjedhor, rezultatet e zgjedhjeve në nivel të vendvotimeve mund të anulohen nëse: KZ dështon të administrojë votimin sipas ligjit; fshehtësia e votës është shkelur; votimi është pezulluar për më shumë se tre orë; policia dështon të reagon në kërkesë për intervenim dhe kjo ka ndikuar në mbajtjen e votimit në vendvotim; ka më shumë vota të hedhura se numri i votuesve që kanë votuar; dhe në rast të votimit në emër të tjetrit. KSHZ është e obliguar të inspektojë materialet zgjedhore nëse në protokollin e KZ-së regjistrohet ndonjë pretendim për parregullsi. Në rast të anulimit, rivotim i zgjedhjeve duhet të mbahet në rast se numri i përgjithshëm i votuesve në Listën e votuesve mund të ndikojë në rezultatet e njësisë zgjedhore.

KSHZ i shqyrtoi ankesat në seanca publike të cilat zgjatën tre ditë dhe të cilat u transmetuan drejtpërdrejtë në televizion. Pavarësisht afatit ligjor prej 48-orësh KSHZ-ja solli vendimin me tre ditë vonesë. Shtatë prej tetë ankesave të dorëzuara nga BESA të cilat pretendonin parregullsi gjatë votimit (presion ndaj votuesve, votim në emër të huaj dhe blerje të votave) u refuzuan për shkak të mungesës së fakteve të bashkangjitur me ankesën. Për më tepër, asnjë protokoll nga vendvotimet e përmendur nuk tregonte parregullsi dhe as KKZ-të nuk kishin pranuar ndonjë vërejtje për protokollin mbi këto çështje.

Ankesa e fundit e BESA-ës kishte të bëjë me një rast ku pretendohet votim në emër të huaj ose tentim votimi të dyfishtë në një vendvotim.⁹¹

LSDM-ja deponoi tetë ankesa, mirëpo dy prej tyre i tërhoqi më 16 dhjetor. Të gjitha ankesat u refuzuan. Asnjë prej ankesave nuk siguroi prova e as baza për anulim të rezultateve meqë referoheshin në korrigjim aritmetik në disa protokolle të KZ-ve.

Për një ankesë u diskutua më shumë se një ditë, në lidhje me një fletëvotim që ishte hequr nga fletorja e fletëvotimeve së bashku me pjesën e numrit serik në lidhjen e fletore. KSHZ-ja i kontrolloi materialet zgjedhorë dhe intervistoi anëtarët e KZ-së dhe KKZ-së.⁹² Disa anëtarë të pavarur të KSHZ-së shfaqën qëllim të qartë për prishjen e rezultateve të vendvotimit me arsye të shkeljes së fshehtësisë së votës edhe pse anëtarët e KZ-së insistuan se ata nuk ishin në dijeni se kush përdori atë fletë dhe për këtë shkak ata nuk mund të gjurmonin identitetin e votuesit.

I tërë procesi i shqyrtimit u pengua nga sjellja joprofesionale e disa anëtarëve të KSHZ-së, sjellja partizane e tyre dhe nga mungesa e organizimit. Anëtarët e KKZ-së dhe të KZ-së u ftuan për pjesëmarrje në seanca në orë të vonshme, u ushtrua presion publik ndaj tyre dhe u kërcënuan me dënime me burg, dhe u morën në pyetje para mediave pa asnjë mbrojtje të identitetit dhe privatësisë së tyre. Ankesat e LSDM-së u shqyrtuan më gjerësisht nga ana e KSHZ-së, krahasuar me ato të BESA-ës, ku KSHZ-ja ftonte anëtarët e KZ-së për të qartësuar korrigjimet e bëra në protokollin e KZ-së dhe hapi kutinë e votimit pa pasur faktet e pretenduara të shënuara në protokollin e KZ-së, siç parashihet me ligj.

Siç u rekomandua më parë, KSHZ-ja duhet të shqyrtojë të gjitha ankesat dhe apelimet në mënyrë të paanshme, pa konsiderata politike. Ligji duhet interpretuar dhe zbatuar në përputhje dhe në linjë me qëllimin e ligjit.

B. APELIMET NË GJYKATËN ADMINISTRATIVE

Pesë apeline u deponuan në Gjykatën Administrative për të sfiduar vendimet KSHZ-së. Një apelim nga ana e VMRO-DPMNE-së sfidonte vendimin e KSHZ-së për anulimin e rezultateve në një nga vendvotimet dhe pesë apeline të LSDM-së që sfidonin vendimin e KSHZ-së për të refuzuar ankesat lidhur me katër vendvotime me pretendime të parregullsive procedurale.

Për herë të parë, Gjykata e Administrative mbajti seancë të hapur publike për këto raste. Gjykatësi i rastit prezantoi çështjen dhe ia dha mundësinë palës apeluase për të shtuar fakte plotësuese relevante. Pas seancave dëgjimore të hapura, secili anëtar në panelin pesë-anëtarësh të gjykatësve votoi gjatë seancës pas dyerve të mbyllura siç parashihet me rregullat e procedurës gjyqësore. Gjykata

⁹¹ Një grua deklaroi se ajo nuk mundi të votojë ditën e zgjedhjeve meqë ishte informuar se emri i saj vetëm se ishte rrethuar në listën e votuesve. KSHZ-ja mori në pyetje KZ-në por edhe më tutje ngeli e paqartë nëse ndokush votoi në emër të saj apo ajo tentoi të votojë dy herë. U thirr një grafolog dhe u konfirmua se nënshkrimet në Listën votuese dhe nënshkrimi i gruas ishin të ndryshëm. KSHZ-ja i anuloi rezultatet e këtij vendvotimi.

⁹² KSHZ-ja kuptoi se mungonte protokollin 15 (pranimi i materialit zgjedhor dhe kushtet e vendvotimit). Fletëvotimi në fjalë ishte gjetur gjatë numërimit dhe barazimit; një shënim në lidhje me këtë fletëvotim u gjet në protokollin e KZ-së për rezultatet mirëpo nuk ndodhej në kopjet karbonike të këtij protokollin.

Administrative vërtetoi tre nga vendimet e KSHZ-së dhe përmbysi dy. Vendimet u publikuan më 20 dhjetor, brenda afatit kohor prej 24 orë të paraparë me ligj.

Në rastin e parë, Gjykata përmbysi vendimin e KSHZ-së për anulimin e rezultatit të një vendvotimi sepse konsideroi se ankesa fillestare e deponuar nga ana e BESA-ës nuk duhet të pranohej nga ana e KSHZ-së meqë nuk ishte e nënshkruar nga ankuesi. Në rastin e dytë, Gjykata përmbysi vendimin e KSHZ-së për vërtetimin e rezultateve të një vendvotimi për arsye procedurale dhe urdhëroi përsëritje të zgjedhjeve për 25 dhjetor 2016. Qasja procedurale e Gjykatës mund të shërbejë si precedent për zhvlerësimin e rezultatit të vendvotimit i cili nuk ndikon në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve, për shkak të gabimeve procedurale, që bie ndesh me detyrimet që dalin nga Kodi Zgjedhor.

C. RIVOTIMI DHE REZULTATET PËRFUNDIMTARE

Më 25 dhjetor, rivotimi u organizua në vendvotimin numër 2011 në Tearcë, njësia zgjedhore 6.⁹³ Sipas KSHZ-së, rivotimi u mbajt në mënyrë të rregullt dhe rezultatet e vendvotimit nuk ndikuan në rezultatet e përgjithshme. Më 28 dhjetor, KSHZ-ja iu dorëzoi certifikatat deputetëve kandidatë të zgjedhur.

Rezultatet përfundimtare të publikuara nga ana e KSHZ-së përmbanin dy mospërputhje. Numri i votave të vlefshme ishte 1,153,984 ndërsa shuma e votave të hedhura për garuesit ishte 1,153,962, (22 vota më pak). Gjithashtu, numri i votuesve që kishin votuar ishte 1,191,852; 2 më shumë se shuma e votave të pavlefshme (37,870) dhe të vlefshme (1,153,984). KSHZ-ja nuk qe në gjendje të shpjegojë për MVZ-në e OSBE/ODIHR arsyen e këtyre mospërputhjeve.

XVII. REKOMANDIME

Këto rekomandime, në përmbajtje të terë tekstit, ofrohen me synimin për të përmirësuar mbajtjen e zgjedhjeve në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë dhe për të mbështetur përpjekjet për t'i sjellë ato në përputhje të plotë me angazhimet e OSBE-së dhe detyrimet dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike. Këto rekomandime duhen lexuar së bashku me rekomandimet e mëparshme të OSBE/ODIHR, posaçërisht me ato në Raportet Përfundimtarë të vitit 2014 dhe qershor 2016, që mbeten për t'u adresuar. OSBE/ODIHR qëndron e gatshme që të ndihmojë autoritetet për të përmirësuar më tej procesin zgjedhor dhe për të trajtuar rekomandimet e përfshira në këtë raport dhe në raportet e mëparshëm.⁹⁴

A. REKOMANDIME PRIORITARE

1. Siç është rekomanduar më parë, Kodi Zgjedhor do të përfitonte shumë nga një rishikim i plotë me qëllim të harmonizimit të tij të brendshëm dhe me ligjet tjerë relevant. Rishikimi duhet kryer në një procedurë publike pas konsultimeve mes aktorëve politikë dhe përfaqësuesve relevant të shoqërisë civile.
2. Siç është rekomanduar më parë, me qëllim të rritjes së transparencës dhe besimit të publikut në punën e saj, të gjitha seancat e KSHZ-së duhet të jenë të hapura për publikun. Procesverbalet e seancave dhe vendimet e KSHZ-ës duhet të publikohen në faqen e saj të internetit rregullisht dhe pa asnjë vonesë.

⁹³ Para rivotimit, dallimi në numër të votave në njësinë numër 6 mes VMRO-DPMNE dhe LSDM ishte 306. Vendvotimi numër 2011 kishte 714 votues të regjistruar që nënkupton se rivotimi mund të ndryshonte numrin e deputetëve të këtyre dy partive nga 51 dhe 49 në 50 për dy partitë.

⁹⁴ Në bazë të paragrafit 24 të [Dokumentit të Stambollit të OSBE-së të vitit 1999](#), Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së u zotuan "të ndjekin me përpikëri vlerësimet e zgjedhjeve dhe rekomandimet e ODIHR".

3. Siç u rekomandua më parë, KSHZ-ja dhe MPB-ja duhet të vazhdojnë me procesin e përditësimit të Listës së votuesve përmes përpjekjeve të koordinuara dhe sipas përgjegjësive dhe procedurave qartë të përkufizuara. Ky proces duhet të trajtojë problemet strukturore në një mënyrë të qëndrueshme, të jetë transparent dhe të sigurojë qasje për partitë politike dhe shoqërinë civile.
4. Duhet të vendosen procedura të hollësishme dhe në kohë për shqyrtimin e listave të kandidatëve me qëllim që të sigurohet qëndrueshmëri dhe gjithpërfshirje e procesit të regjistrimit, përfshirë edhe dhënien e kohës së mjaftueshme për garuesit që të korrigjojnë parregullsitë. Një rishikim i Kodit Zgjedhor mund të konsiderojë specifikimin e të gjitha kushteve dhe të dokumentacionit të nevojshëm për tërheqjen dhe zëvendësimin e listave të kandidatëve.
5. Duhet të vendoset një mekanizëm për korrigjim me kohë dhe efektiv për të gjithë qytetarët me të drejtë vote të cilët nuk u gjetën në Listën e votuesve me qëllim që ata të mund të realizojnë të drejtën e tyre për votë.
6. Qytetarët, përfshirë edhe punonjësit publikë, nuk duhet të jenë objekt i presionit apo frikësimit. Autoritetet dhe partitë politike duhet të marrin hapa më të vendosur që të sigurojnë të mos ushtrohet presion ndaj punonjësve të sektorit publik, aktivistëve politikë apo personave të tjerë për të marrë pjesë në aktivitetet e fushatës apo për të votuar në një mënyrë të caktuar. Autoritetet duhet në kohë, tërësisht dhe në mënyrë efikase të hetojnë dhe të ndjekin penalisht të gjitha rastet dhe pretendimet për presion dhe frikësim të ushtruar ndaj votuesve.
7. Duhet bërë përpjekje për forcimin e mëtejshëm të pavarësisë editoriale të mediave publike nga ndikimi politik me qëllim që të lehtësohet qasja e qytetarëve në informacion pluralist.
8. Siç u rekomandua më parë, KSHZ-ja duhet të shqyrtojë të gjitha ankesat dhe apelimet në mënyrë të paanshme, pa konsiderata politike. Ligji duhet interpretuar dhe zbatuar në përputhje dhe në linjë me qëllimin e ligjit.

B. REKOMANDIME TJERA

Sistemi Zgjedhor

9. Mund të merret parasysh rishikimi i pragut për njësinë zgjedhore jashtë shtetit me qëllim që të sigurohet përfaqësimi parlamentar i këtyre votuesve. Ky mund të jetë në raport proporcional me jehonën e votuesve sikur që është rasti me votuesit e njësisive votuese brenda vendit.
10. Legjislacioni duhet të parasheh rishikim periodik të kufijve të njësisive zgjedhore të bërë nga ana e një organi të pavarur duke u bazuar në ndryshimet e numrit të popullatës. Kur të bëhet ridefinimi i kufijve të njësisive zgjedhore, ai duhet bërë në mënyrë transparente, të paanshme dhe përfshirëse.

Administrimi i Zgjedhjeve

11. Duhet të merret në konsideratë revidimi i Rregullave të Procedurës të KSHZ-së me qëllim të përmirësimit të organizimit të brendshëm, efikasitetit dhe transparencës në punë.
12. Siç është rekomanduar më parë, për të siguruar qëndrueshmëri të kapacitetit administrativ të KSHZ-së të gjitha pozitat esenciale mbështetëse duhet të jenë të përhershme, dhe kjo të bëhet përmes një procesi të hapur dhe konkurrues të rekrutimit.

13. KSHZ-ja duhet në kohë të qartësojë të gjitha procedurat e papërpunuara nga Kodi Zgjedhor. Të gjitha qartësimet duhet të jenë në përputhje me dispozitat e Kodit Zgjedhor.
14. KSHZ-ja duhet të merr në konsideratë sigurimin e trajnimeve më gjithëpërfshirës për komisionet e nivelit më të ulët me fokus në procedurat e ditës së zgjedhjeve.
15. KSHZ-ja duhet të merr në konsideratë hartimin me kohë të një programi gjithëpërfshirës edukativ, gjithashtu edhe në gjuhët e pakicave kombëtare. Vëmendje e veçantë duhet kushtuar shënimit të fletëvotimeve nga ana e votuesve dhe fshehtësisë së votës.

Regjistrimi i Votuesve

16. Të gjithë votuesit me të drejtë vote duhet të shtohen në listat e votuesve pavarësisht vlefshmërisë së letërnjoftimeve apo pasaportave të tyre, ashtu siç e parasheh Kushtetuta.
17. Ligji për Banim të Përhershëm dhe të Përkohshëm duhet të korrigjohet që të përcaktojë definicione të qëndrueshme për banimin e përkohshëm dhe të përhershëm të qytetarëve që jetojnë brenda dhe jashtë shtetit, si dhe mekanizma efikas për MPB-në për përditësim të regjistrimit të adresave. Mospërputhjet ligjore duhet të trajtohen me qëllim që të sigurohet saktësi në regjistrimin e të dhënave të votuesve në bazë të vendit ku aktualisht banojnë qytetarët.
18. Me qëllim që të rritet besimi i publikut në këtë proces, duhet të ndërmerren masa për të siguruar që regjistrimi aktiv për votim jashtë vendit të kryhet vetëm nga ana e votuesit.

Regjistrimi i Kandidatëve

19. Siç u rekomandua më parë, me qëllim që të zvogëlohet mundësia për frikësim, mund të merret në konsideratë sigurimi i metodave alternative për grumbullimin e nënshkrimeve ose lejimi i depozitimit të fondeve.
20. Partitë duhet të konsiderojnë masa të brendshme për avancimin e grave në pozita më të larta brenda strukturave partiake dhe përfshirjen në listat e kandidatëve në pozita me mundësi fituese.

Financimi i Fushatës

21. Mund të merret në konsideratë që ESHA-së ti jepen kompetenca ex officio për kryerje të auditimit të plotë të financimit të fushatave, përfshirë edhe kërkimin e dokumentacionit dhe informacionit plotësues nga garuesit, për të siguruar shqyrtim gjithëpërfshirës kundër ndonjë shkeljeje të mundshme.

Media

22. Çdo blerje e reklamave të financuara nga qeveria në mediat private duhet gjithnjë të bëhet në bazë të kriterëve objektiv dhe jo diskriminues, me transparencë të plotë dhe në kohë të harxhimeve të bëra.
23. Siç u rekomandua më parë, detyrimi ligjor i MRT për të mundësuar kohëzgjatje ekzakte në çdo edicion lajmesh të dedikuar mbulimit të aktiviteteve të fushatës së një garuesi individual mund të zëvendësohet me një detyrim më të përgjithshëm, për të mundësuar paanshmëri dhe balancë duke respektuar pavarësinë editoriale.

24. Dispozitat që përcaktojnë shpërndarjen e reklamimit të paguar mund të rishikohen me qëllim që të mundësohet qasje më e madhe për partitë jo-parlamentare.
25. Siç u rekomandua më parë, Kodi Zgjedhor mund të ndryshohet për të qartësuar detyrimet për raportim të balancuar gjatë periudhës parazgjedhore. Mund të merret në konsideratë përforcimi i mëtejme i pavarësisë të AMSSA-së duke i dhënë resurse më të mëdha për sigurimin e rolit mbikëqyrës të tij dhe duke i siguruar kompetenca sanksionuese efektive, proporcionale dhe ndaluese.

Ankesa dhe Apelime

26. Siç u rekomandua më parë, Kodi Zgjedhor duhet të harmonizohet me Kushtetutën dhe qartësisht të përcaktojë se të gjitha seancat dëgjimore gjyqësore për rastet që kanë të bëjnë me zgjedhjet duhet të jenë të hapura për publikun dhe vendimet duhet të publikohen menjëherë.
27. Mund të merret në konsideratë decentralizimi i mekanizmit për zgjidhje të kontesteve zgjedhore. KKZ-të mund të obligohen me detyrë për trajtimin e ankesave për çështjet të cilat bien në përgjegjësitë e tyre administrative që të mundësohet kompensim efektiv dhe në kohë.

Pjesëmarrja e Pakicave Kombëtare

28. Mediat duhet të ndajnë më shumë hapësirë për komunitetet më të vogla dhe përfaqësuesit e tyre. Fushatat për ndërgjegjësim dhe edukim të votuesve, përfshirë edhe të drejtën e votuesit për të hedhë votën pa frikë nga hakmarrja, duhet të kenë në shënjestër komunitetet më të vogla dhe mundësisht të jenë në gjuhën e komunitetit.

Dita e Zgjedhjeve

29. Për të iu shmangur heqjes të së drejtës për votim në burg, duhet korrigjuar mangësitë ligjore që kanë të bëjnë me përtëritjen e dokumenteve të tyre të identifikimit.
30. Duhet të ndërmerren masa për sigurimin e qasjes në të gjitha vendvotimet për personat me aftësi të kufizuara.

ANEKS I: ANEKS 1: REZULTATET PËRFUNDIMTARE⁹⁵

	Numri		Për qind
Votues të regjistruar	1,784,416		
Votues të cilët votuan	1,191,852		66.79
Vota të vlefshme	1,153,984		96.82
Vota të pavlefshme	37,870		3.18
Rezultate			
Partitë/Koalicionet	Vota	Për qind	Mandate
Koalicioni i udhëhequr nga Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase – Partia Demokratike e Unitetit Kombëtar Maqedonas (VMRO–DPMNE)	454,577	38.14	51
Partia Demokratike Shqiptare (PDSH)	30,964	2.60	2
Koalicioni Bashkimi Demokratik për Integrim (BDI)	86,796	7.28	10
Koalicioni i udhëhequr nga Lidhja Social Demokrate e Maqedonisë (LSDM)	436,981	36.66	49
Koalicioni për Ndryshime dhe Drejtësi – Blloku i Tretë (KND)	10,028	0.84	0
Partia për Prosperitet Demokratik (PPD)	1,143	0.10	0
Koalicioni “Aleanca për Shqiptarët”	35,121	2.95	3
Partia Liberale	3,840	0.32	0
Koalicioni VMRO për Maqedoni	24,524	2.06	0
Lëvizja BESA	57,868	4.86	5
E Majta (<i>Levica</i>)	12,120	1.02	0
Gjithsej numri i votave	1,153,962	96.83	120

⁹⁵ Mbledhja e të dhënave sipas rezultateve përfundimtare të publikuara në [faqen e internetit](#) të KSHZ-së.

ANEKS II: LISTA E VËZHguesVE NË MISIONIN VËZHgues NDËRKOMBËTAR TË ZGJEDHJEVE

VËZHguesIT AFATSHKURTËR

Asambleja Parlamentare e OSBE-së

Roberto	BATTELLI	Slloveni	Koordinator Special
Azay	GULIYEV	Azerbajxhan	Shef i Delegacionit
Berivan	ASLAN	Austri	
Wolfgang	GERSTL	Austri	
Dimitar	DELTCHEV	Bullgari	
Kiril	TZOTCHEV	Bullgari	
Kristian	VIGENIN	Bullgari	
Thomas	STRITZL	Gjermani	
Georgios	VAREMENOS	Greqi	
Luigi	COMPAGNA	Itali	
Sergio	DIVINA	Itali	
Helen	KONZETT-BARGETZE	Lihtenshtajn	
Malgorzata	GOSIEWSKA	Poloni	
Sven-Olof	SAELLSTROEM	Suedi	
Necdet	UNUVAR	Turqi	
Mir Kamal	ALIZADA	Azerbajxhan	
Milovan	PETKOVIĆ	Kroaci	
Georgios	CHAMPOURIS	Greqi	
Monica	DELLI PRISCOLI	Itali	
Cenk	ILERI	Turqi	
Andreas	NOTHELLE	Gjermani	
Francesco	PAGANI	Itali	
Maria	CHEPURINA	Federata Ruse	
Iryna	SABASHUK	Ukrainë	

Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës

Stefan	SCHENNACH	Austri	Shef i Delegacionit
Vusal	HUSEYNOV	Azerbajxhan	
Muslum	MAMMADOV	Azerbajxhan	
Saša	MAGAZINOVIĆ	Bosnje dhe Hercegovinë	
Valeri	JABLIANOV	Bullgari	
Predrag	SEKULIC	Mali i Zi	
Pauline	KRIKKE	Holandë	
Frank	JENSSEN	Norvegji	
Luis Leite	RAMOS	Portugali	
Matjaz	HANZEK	Slloveni	
Saban	DISLI	Turqi	
Vladyslav	GOLUB	Ukrainë	
George	FOULKES	Mbretëria e Bashkuar	
Domenico	VALLARIO	Itali	Komisioni i Venecias
Käre	VOLLAN	Norvegji	Komisioni i Venecias
Franck	DAESCHLER	Francë	Sekretariat
Bogdan	TORCATORIU	Rumuni	Sekretariat
Anne	GODFREY	Mbretëria e Bashkuar	Sekretariat

Parlamenti Evropian

Igor	ŠOLTES	Sllloveni	Shef i Delegacionit
Angel	DZHAMBAZKI	Bullgari	
Andrey	KOVATCHEV	Bullgari	
Tonino	PICULA	Kroaci	
Joëlle	BERGERON	Francë	
Jens	NILSSON	Suedi	
Maria	SPYRAKI	Greqi	
Martin	FILIPOV	Bullgari	
Jörgen	SIL	Estoni	
Julianna	HUSZAR-DEKANY	Hungari	
Paolo	BERGAMASCHI	Itali	
Johana	MARESCAUX	Republika Çeke	Sekretariat
Nikos	SALLIARELIS	Greqi	Sekretariat
Helen	COLLINS	Irlandë	Sekretariat
Gerrard	QUILLE	Mbretëria e Bashkuar	Sekretariat

Vëzhguesit afatshkurtër të MVZ të OSBE/ODIHR

Uarda	CELAMI	Shqipëri
Erinda	TOSKA	Shqipëri
Manfred	ASCHABER	Austri
Florian	DOSCHEK	Austri
Thomas	MUEHLMANN	Austri
Iris	O'ROURKE	Austri
Thomas	BOTTERMAN	Belgjikë
Hugo	BRAUWERS	Belgjikë
Frederic	DE CONINCK	Belgjikë
Joris	VANHEE	Belgjikë
Viktoria	CHACHEVA	Bullgari
Konstantina	KOSTOVA	Bullgari
Dimitar	STANCHEV	Bullgari
Elizabeta	MADAREVIC	Kroaci
Martina	VRDOLJAK	Kroaci
Josip	JURIC	Kroaci
Hana	BRODSKA	Republika Çeke
Adam	DRNOVSKY	Republika Çeke
Jan	FALTUS	Republika Çeke
Eva	JANU	Republika Çeke
Martin	KOSATKA	Republika Çeke
Jane	KOVARIKOVA	Republika Çeke
Petra	KRATOCHVILOVA	Republika Çeke
Oldrich	LACINA	Republika Çeke
Pavel	PINKAVA	Republika Çeke
Valdemar	URUBA	Republika Çeke
Milena	LEVICKOVA	Republika Çeke
Lars	ANDERSEN	Danimarkë
Daniel	MUNK	Danimarkë
Birte Torp	PEDERSEN	Danimarkë
Ingegerd Nissen	PETERSEN	Danimarkë

Michael	RASMUSSEN	Danimarkë
Preben Thue	RASMUSSEN	Danimarkë
Peter	RAVN	Danimarkë
Anemette	VESTERGAARD	Danimarkë
Albert Volmer Major	WRIGHT	Danimarkë
Sulev	LÄÄNE	Estoni
Lilian	PALLUM	Estoni
Erkki Johannes	AALTO	Finlandë
Kimmo	COLLANDER	Finlandë
Heidi Kaarina	KOTAMÄKI	Finlandë
Anu Tytti Helena	VIRTANEN	Finlandë
Alexandre	BALGUY-GALLOIS	Francë
Emmanuelle	CERF	Francë
Clémence	CONTENSOU	Francë
Laurent	LEMARCHAND	Francë
Mounia	MALKI	Francë
Loïc	TREGOURES	Francë
Ingo David	BUETTNER	Gjermani
Birgit	DAIBER	Gjermani
Helmut Julius	GOESER	Gjermani
Mendel	GOLDSTEIN	Gjermani
Holger	HEMBACH	Gjermani
Tom Sobjerg	HOYEM	Gjermani
Dorothee	HUTTER	Gjermani
Clemens	JUERGENMEYER	Gjermani
Helmut Dirk Paul	KLAWONN	Gjermani
Peter Fritz	KOHLMEIER	Gjermani
Annelie	KOSCHELLA	Gjermani
Juliane	MARKARD NARTEN	Gjermani
Heiko	MEINHARDT	Gjermani
Konrad	MENNY	Gjermani
Nicolas	NACHTIGALL-MARTEN	Gjermani
Heinz Helmut	NÄGELE	Gjermani
Reinhold Stephan Vincenz	OSTERHUS	Gjermani
Jens	PRINZHORN	Gjermani
Regine	REIM	Gjermani
Hans-Heinrich Josef	RIESER	Gjermani
Hildegard Christine Maria	ROGLER-MOCHEL	Gjermani
Anke	SMOLLICH	Gjermani
Guenter	VOLK	Gjermani
Robert	WERNER	Gjermani
Erik Gyula	BAKTAI	Hungari
Robert	KASZAB	Hungari
Brigitta	LENGYEL	Hungari
Elza	SCHÖNSTEIN	Hungari
Gábor	SZEKERES	Hungari
Krisztina	TIHANYI	Hungari
Fionnuala	BRENNAN	Irlandë

William	BULMAN	Irlandë
Pauline	CONWAY	Irlandë
Frank	KENNEFICK	Irlandë
Olivia	MITCHELL	Irlandë
Ferdinando	LAJOLO DI COSSANO	Itali
Enza	PETRILLO	Itali
Nadia	RANERI	Itali
Tetsuya	SAHARA	Japoni
Fumiyo	TAKAI	Japoni
Anete	KARKLINA-LUROPE	Letoni
Rita	STAFEJEVA	Lituani
Jonkheer Willem Hendrik	DE BEAUFORT	Holandë
Onno Willem Cornelis	HATTINGA VANT SANT	Holandë
Johannes Martinus	STIENEN	Holandë
Willem Wouter	PLOMP	Holandë
Henriette Suzanne	WINKLER	Holandë
Andri Stefansson	VAN MENS	Holandë
Wouter Hendrik	SIMONIS	Holandë
Maurits	VAN HEEK	Holandë
Alida Jay	BOYE	Norvegji
Silje Evjen	HANSEN	Norvegji
Kari	HESSELBERG	Norvegji
Grzegorz	LEWOCKI	Poloni
Anna	MAKOWSKA-LEWOCKA	Poloni
Arkadiusz	SEMENIUK	Poloni
Anna	PILASZEK	Poloni
Corina Ana-Maria	ARTENI	Rumuni
Bogdan Ovidiu	BIRIS	Rumuni
Ioana Maria	DUMITRIU	Rumuni
Mihaela-Olivia	PAVEL	Rumuni
Dmitry	ALYAKIN	Federata Ruse
Sergey	ANDRIASHIN	Federata Ruse
Iuliia	ANTONOVA	Federata Ruse
Kristina	BOGDANOVA	Federata Ruse
Aleksei	BOGUSLAVSKII	Federata Ruse
Iurii	BOICHENKO	Federata Ruse
Elizaveta	BORISOVA	Federata Ruse
Andrey	BORODIN	Federata Ruse
Alexey	CHUMICHEV	Federata Ruse
Svetlana	DYMBRYLOVA	Federata Ruse
Evgenii	EGOROV	Federata Ruse
Sergei	ERMAKOV	Federata Ruse
Igor	ERMOLENKO	Federata Ruse
Vladislava	FADEEVA	Federata Ruse
Aleksei	FILIPPOV	Federata Ruse
Yury	GORBATYUK	Federata Ruse
Anna	GOZHINA	Federata Ruse
Alexander	KOBRINSKIY	Federata Ruse
Yulia	KOROTUN	Federata Ruse

Svetlana	KORZHOVA	Federata Ruse
Evgenia	LITVIN	Federata Ruse
Elena	LOBODA	Federata Ruse
Nikolai	MAKAROV	Federata Ruse
Vladimir	MATIUKHIN	Federata Ruse
Igor	MEDNIKOV	Federata Ruse
Anna	MOROZOVA	Federata Ruse
Natalia	NAUMOVA	Federata Ruse
Maria	NIKIFOROVA	Federata Ruse
Yuliana	PETRENKO	Federata Ruse
Yulia	PLOKHOVA	Federata Ruse
Sergey	RAKITIN	Federata Ruse
Dmitry	REPKOV	Federata Ruse
Leili	RUSTAMOVA	Federata Ruse
Asia	SEMEANOVA	Federata Ruse
Anna	SHAINOGA	Federata Ruse
Aleksandr	SHALAK	Federata Ruse
Vilyam	SMIRNOV	Federata Ruse
Olga	TATARCHENKOVA	Federata Ruse
Valery	TIKHONOV	Federata Ruse
Elizaveta	TITKOVA	Federata Ruse
Faina	USOVA	Federata Ruse
Filipp	VOSKRESENSKII	Federata Ruse
Sergei	ZENKOV	Federata Ruse
Marina	ZHILKINA	Federata Ruse
Alexander	ZHUROV	Federata Ruse
Tibor	CHLUPIK	Sllovaki
Darinka	BOGDANOVIC	Slloveni
Maja	ZBOGAR	Slloveni
Kazi Abdul Kalam Muhammed	ALI	Mbretëria e Bashkuar
Nicholas Jordan	BRIMBLE	Mbretëria e Bashkuar
Andrew Frew	CALDWELL	Mbretëria e Bashkuar
Max	CALLER	Mbretëria e Bashkuar
Ian Pallister	CRAMMAN	Mbretëria e Bashkuar
Charles Edward	FITZHERBERT	Mbretëria e Bashkuar
Richard Paul	GOAD	Mbretëria e Bashkuar
Dally Tariq	HAKEM	Mbretëria e Bashkuar
Adrian Francis	I'ANSON	Mbretëria e Bashkuar
Oliver	JOSEPH	Mbretëria e Bashkuar
Mia (Camilla Persephone Lenox)	MARZOUK	Mbretëria e Bashkuar
John	MILLS	Mbretëria e Bashkuar
Catherine Mary	PIDCOCK	Mbretëria e Bashkuar
Bernard Joseph	QUOROLL	Mbretëria e Bashkuar
Thomas Legh	RICHARDSON	Mbretëria e Bashkuar
Michael David	SANDER	Mbretëria e Bashkuar
Robin Alan	SELLERS	Mbretëria e Bashkuar
Alison	SUTHERLAND	Mbretëria e Bashkuar
David John	TAYLOR	Mbretëria e Bashkuar

Maureen Christie	TAYLOR	Mbretëria e Bashkuar
Carmen	DE ANTONIO SERRANO	Spanjë
Javier	DE CASTRO	Spanjë
María Neus	FERNANDEZ QUETGLAS	Spanjë
Irene	MARTIN CORTES	Spanjë
Ana María	SANCHEZ CAMBON	Spanjë
Claes Johan	ALEXANDERSSON	Suedi
Stellan	BACKLUND	Suedi
Linda	CEDERBLAD	Suedi
Tommy	KARLSSON	Suedi
Hans Birger	NAERESKOG	Suedi
Helena	MUNTHER	Suedi
Anna	ROGALSKA HEDLUND	Suedi
Kerstin	SUNDBERG	Suedi
Bjorn Mikael	TEDEMAN	Suedi
Fabrizio	COMANDINI	Zvicër
Pia	GIANINAZZI	Zvicër
Annette	KELLER	Zvicër
Martin Paul	MINDER	Zvicër
Max	OSER	Zvicër
Frank	WIEDERKEHR	Zvicër
Sheila	BELOMETTI	Zvicër
Hüseyin Avni	BIÇAKLI	Turqi
Shaun	BARCAVAGE	Shtetet e Bashkuara
James	BERK	Shtetet e Bashkuara
Darin	BIELECKI	Shtetet e Bashkuara
Shamus	BRENNAN	Shtetet e Bashkuara
Catharine	CASHNER	Shtetet e Bashkuara
J. Bruce	CLARK	Shtetet e Bashkuara
Pedro	CORTES	Shtetet e Bashkuara
Ward	CROMER	Shtetet e Bashkuara
Philip	DANIEL	Shtetet e Bashkuara
Jeffrey	ERLICH	Shtetet e Bashkuara
Augusta	FEATHERSTON	Shtetet e Bashkuara
Meaghan	FITZGERALD	Shtetet e Bashkuara
Anslem (JR)	GENTLE	Shtetet e Bashkuara
Hedy	GLENN	Shtetet e Bashkuara
Amy	HAMBLIN	Shtetet e Bashkuara
Nanacy	LEEPER	Shtetet e Bashkuara
Evelyn	LENNON	Shtetet e Bashkuara
Imre	LIPPING	Shtetet e Bashkuara
Marie-Celeste	MARCOUX	Shtetet e Bashkuara
Andrea (Shelley)	MCTHOMAS	Shtetet e Bashkuara
Joseph	MEYER	Shtetet e Bashkuara
Barbara	MILLER	Shtetet e Bashkuara
Steven (Mitch)	MORAN	Shtetet e Bashkuara
Jeremy	PINE	Shtetet e Bashkuara
Octavius	PINKARD	Shtetet e Bashkuara

Rebecca	RIPLEY	Shtetet e Bashkuara
Constance (Connie)	ROBINSON	Shtetet e Bashkuara
Timothy James	SCOTT	Shtetet e Bashkuara
Haris	SOFRADZIJA	Shtetet e Bashkuara
Caroleen	WILLIAMS	Shtetet e Bashkuara
Sirli	HILL	Shtetet e Bashkuara
Greg	FINK	Shtetet e Bashkuara
Edward	GONZALEZ	Shtetet e Bashkuara
Bruce	ZACHARZUK	Shtetet e Bashkuara

Ekipi i ekspertëve i MVZ të OSBE/ODIHR

Tana	DE ZULUETA	Itali	Shefe e Misionit
Raul	MUREȘAN	Rumuni	
Aleksandra	PAJEVIĆ	Mal i Zi	
Alessandro	ROTTA	Itali	
Maša	JANJUŠEVIĆ	Serbi	
Tania	MARQUES	Portugali	
Ovidiu	CRAIU	Rumuni	
Marek	MRAČKA	Slovaki	
Mario	ORRU	Itali	
Karolina	RIEDEL	Suedi	
Jonathan	MELLON	Mbretëria e Bashkuar	
Monica	MORAVCOVA	Republika Çeke	
Tatjana	PEROVIĆ	Serbi	
Pawel	JURCZAK	Poloni	
Tomasz	JANCZY	Poloni	
Angela	GHILAȘCU	Moldavi	
Peter	BOOKER	Mbretëria e Bashkuar	

Vëzhguesit afatgjatë të MVZ të OSBE/ODIHR

Christian Oliver	HYNEK	Austri
Olga	NEZMESKALOVA	Republika Çeke
Karen Benedikte	SKIPPER	Danimarkë
Kilian	HOCQUART	Francë
Christoph	WIEDEMANN	Gjermani
Michael	WIERSING	Gjermani
Cecilia Rose	KEAVENEY	Irlandë
Simone	BROCCHI	Itali
Aida	MASYLKANOVA	Republika e Kërgistanit
Laurens	TEULE	Holandë
Servatius	WIEMERS	Holandë
Per N.	SVARTEFOSS	Norvegji
Elof David	DAHMEN	Suedi
Vida	KOREN HOLM	Suedi
Sascha Michel	ALDERISI	Zvicër
Monica Angela	GIAMBONINI	Zvicër

Roger	BRYANT	Mbretëria e Bashkuar
Joan	PEARCE	Mbretëria e Bashkuar
Michael David	ELDRED	Shtetet e Bashkuara
Jessica Cathrine	NASH	Shtetet e Bashkuara

RRETH OSBE/ODIHR

Zyra për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE/ODIHR) është institucioni kryesor i OSBE-së që ndihmon Shtetet pjesëmarrëse “të sigurojnë respektim të plotë të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, të respektojnë shtetin e së drejtës, të promovojnë parimet e demokracisë dhe (...) të ndërtojnë, të forcojnë dhe të mbrojnë institucionet demokratike, si dhe të promovojnë tolerancën në të gjitha nivelet e shoqërisë” (Dokumenti i Samitit të Helsinkit 1992). Kjo pjesë njihet si dimension i njerëzor i OSBE-së.

OSBE/ODIHR, me seli në Varshavë (Poloni), u krijua në Samitin e Parisit në vitin 1990 si Zyra për Zgjedhje të Lira dhe filloi funksionimin në maj 1991. Një vit më vonë, emri i Zyrës u ndryshua për të pasqyruar një mandat më të zgjeruar, në të cilin do të përfshiheshin të drejtat e njeriut dhe demokratizimi. Sot organizata punëson mbi 130 vetë.

OSBE/ODIHR është organizata kryesore në Evropë në fushën e vëzhgimit të zgjedhjeve. Çdo vit bashkërendon dhe organizon dërgimin e mijëra vëzhguesve për të vlerësuar nëse zgjedhjet në rajonet e OSBE-së janë zhvilluar në përputhje me angazhimet e OSBE-së, me detyrimet e tjera ndërkombëtare, me standardet për zgjedhje demokratike dhe me legjislacionin vendas. Metodologjia e tij unike siguron një vështrim të hollësishëm dhe në tërësi të procesit zgjedhor. Me anë të projekteve të asistencës, OSBE/ODIHR ndihmon Shtetet pjesëmarrëse të përmirësojnë kornizën e tyre zgjedhore.

Aktivitetet e Zyrës për demokratizim përfshijnë: sundimin e ligjit, mbështetjen legjislative, qeverisjen demokratike, migrimin dhe lirinë e lëvizjes, si dhe barazinë gjinore. OSBE/ODIHR zbaton çdo vit një numër programesh asistence të fokusuar, duke synuar zhvillimin e strukturave demokratike.

OSBE/ODIHR gjithashtu ndihmon shtetet pjesëmarrëse në përmbushjen e detyrimeve të tyre për të promovuar dhe mbrojtur të drejtat e njeriut dhe liritë themelore në përputhje me angazhimet e OSBE-së për dimensionin njerëzor. Kjo arrihet duke punuar me një shumëllojshmëri partnerësh, me qëllim nxitjen e bashkëpunimit, krijimin e kapaciteteve dhe ofrimin e ekspertizës në fusha tematike, duke përfshirë të drejtat e njeriut në luftën kundër terrorizmit, forcimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut të personave të trafikuar, edukimin dhe trajnimin mbi të drejtat e njeriut, monitorimin e të drejtave të njeriut dhe raportimet, dhe të drejtat e njeriut të grave dhe sigurinë e tyre.

Në fushën e tolerancës dhe mosdiskriminimit, OSBE/ODIHR u siguron mbështetje Shteteve pjesëmarrëse për forcimin e përgjigjes së tyre ndaj krimeve të urrejtjes dhe incidenteve të racizmit, ksenofobisë, antisemitizmit dhe formave të tjera të jotolerancës. Aktivitetet e OSBE/ODIHR në lidhje me tolerancën dhe mosdiskriminimin janë të fokusuar në fushat e mëposhtme: legjislacioni, trajnimi për zbatimin e ligjit, monitorimi, raportimi për krimet dhe incidentet e motivuara nga urrejtja dhe informatë përcjellëse për përgjigjen e dhënë, si edhe aktivitete edukative për të promovuar tolerancën, respektin dhe mirëkuptimin e ndërsjellë.

OSBE/ODIHR këshillon Shtetet pjesëmarrëse mbi politikën e tyre për komunitetet Rome dhe Sinti. Zyra nxit ngritjen e kapaciteteve dhe krijimin e lidhjeve mes komuniteteve Rome dhe Sinti, si dhe inkurajon pjesëmarrjen e përfaqësuesve Romë dhe Sinti në organet e politikëbërjes.

Të gjitha aktivitetet e ODIHR realizohen në bashkëpunim dhe koordinim të ngushtë me Shtetet pjesëmarrëse të OSBE-së, institucionet dhe misionet e shtrira të OSBE-së, si dhe me organizata të tjera ndërkombëtare.

Informacione të mëtejshme mund të gjeni në faqen e internetit të ODIHR (www.osce.org/odihr).